



KOMITETI SHQIPTAR I HELSINKIT



RAPORT MONITORIMI

**MBI TË DREJTAT DHE
LIRITË E EMIGRANTËVE,
AZILKËRKUESVE DHE
REFUGJATËVE NË SHQIPËRI**



KOMITETI SHQIPTAR I HELSINKIT

RAPORT MONITORIMI

MBI TË DREJTAT DHE LIRITË E EMIGRANTËVE, AZILKËRKUESVE DHE REFUGJATËVE NË SHQIPËRI

*Referuar gjetjeve të monitorimeve të kryera nga KShH në periudhën Shtator 2018
– Qershor 2019*

Publikuar në, Mars 2020

Ky raport është përgatitur nga Komiteti Shqiptar i Helsinkit, në kuadër të projektit ‘Kontribut për një respektim më të mirë të të drejtave të azilkërkuesve dhe refugjatëve në Shqipëri’, mbështetur nga Ambasada e Mbretërisë së Vendeve të Ulëta në Tiranë, në kuadër të programit Matra Rule of Law.

Përgatiti:

- 1. Znj. Sonila Kamami, eksperte e jashtme, KShH**

Rishikuan:

- 1. Znj. Erida Skëndaj, Drejtore Ekzekutive, KShH**
- 2. Znj. Miriam Angoni, Drejtore Programi, KShH**
- 3. Znj. Roven Vuksani, Juriste, KShH**
- 4. Znj. Ardita Kolmarku, Juriste, KShH**

Të gjitha të drejtat janë të rezervuara për subjektin autor. Asnjë pjesë e këtij botimi nuk mund të riprodhohet pa lejen dhe citimin e tij.

Autor: ©Komiteti Shqiptar i Helsinkit

Rr. Brigada e VIII-te, Pallati “Tekno Projekt” Shk 2 Ap 10, Tirana-Albania

Kutia Postare nr.1752 Tel: 04 2233671

Cel: 0694075732

E-mail: office@ahc.org.al; web site: www@ahc.org.al

PËRMBAJTJA

SHKURTIMET	4
TERMINOLOGJIA	5
HYRJE	7
1.1 Konteksti mbi situatën e fenomenit të migracionit	7
2. PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE.....	9
KAPITULLI I	12
METODOLOGJIA E PËRDORUR NË REALIZIMIN E RAPORTIT	12
1.1. Metodologjia.....	12
1.2. Zona gjeografike, objekt i këtij studimi	12
1.3. Limitet metodologjike	13
KAPITULLI II	15
MONITORIMI I TË DREJTAVE TË MIGRANTËVE NË SHQIPËRI	15
2.1. Të dhëna statistikore për migrantët	15
2.1.2. Azilkërkuesit në Qendrën Kombëtare Pritëse në Babrru (Tiranë)	24
2.2. Monitorimi i respektimit të të drejtave të migrantëve të ndaluar në institucionet e kufirit dhe migracionit	25
2.2.1. Organika institucionale e personelit	25
2.2.2. Problematikat e konstatuara lidhur me mjetet logjistike dhe infrastrukturën e nevojshme.....	32
2.3. Monitorimi i respektimit të të drejtave të Azilkërkuesve në Qendrën Kombëtare Pritëse	35
2.3.1. Organika institucionale e personelit	35
2.3.2. Njohja me rregulloren e Qendrës	36
2.3.3. Infrastruktura e kufizuar në raste fluksi.....	36
2.3.4. Mangësitë në buxhet dhe mjetet logjistike	37
2.4. Zbatimi i ligjit, rregulloreve, urdhrave	37
2.4.1. Koha e qëndrimit në ambientet e shoqërimit	37
2.4.2. Parregullsitë në dokumentacion (formularë)	37
2.4.3. Problematikat mbi zbatimin e Urdhërit nr. 805/2017 të Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit	38
REKOMANDIME	39
LITERATURA.....	41
ANEKS	42

SHKURTIMET

DVPMK	Drejtoria Vendore e Policisë, Migracionit dhe Kufirit
KKM	Komisariati i Kufirit dhe Migracionit
KPK	Komisariati i PolicisëKufitare
KShH	Komiteti Shqiptar i Helsinkit
OKB	Organizata e Kombeve tëBashkuara
QKP	Qendra KombëtarePritëseBabrru
GjEDNJ	Gjykata Europiane e të Drejtave të Njeriut
INTERPOL	International Criminal Police Organization
PKK	Pikat e KalimitKufitar
RSH	Republika e Shqipërisë
RMSA	Refuges and Emigrants Services Albania
SPK	Stacioni i PolicisëKufitare
UNHCR	United Nations High Commissioner for Refugees

TERMINOLOGJIA

“*I huaj*”¹ është çdo person, me ose pa shtetësi, i cili, sipas legjislacionit shqiptar, nuk është shtetas shqiptar. Ky term përdoret në mënyra të ndryshme (*imigrant, migrant, refugjat, klandestinë*), duke treguar herë pas here kategori shumë të ndryshme midis tyre. Thuhet se është i huaj, në përgjithësi, duke përfshirë si ata që kanë jetuar për vite me radhë në vendin tonë, ashtu edhe ata që këtu janë thjesht kalimtarë. Ka të “*huajt*” që kanë fituar një leje qëndrimi të rregullt për punë, bashkim familjar, studim dhe trajnim, ose për arsye politike dhe/ose fetare, që kanë jetuar në vendin tonë për një kohë të gjatë dhe janë të autorizuar të jenë të pranishëm në territorin tonë. Gjithashtu, kemi të “*huajt*” të përqendruar në ambientet e pritjes, shpesh pa vendbanim, që kanë lënë vendin e tyre të origjinës dhe pasi kanë paraqitur një kërkesë për azil, ende janë në pritje të një vendimi nga autoritetet e vendit pritës. Në rast të pranimit të kërkesës ata do të bëhen refugjatë, të rregullt, përndryshe do të jenë klandestinë. Dhe së fundi, ka të “*huajt*” që janë emigrantë të paligjshëm nga origjina e tyre, të cilët mbërrijnë në Shqipëri dhe nuk aplikojnë për azil, duke konceptuar territorin tonë si një destinacion tranzit në udhëtimin e tyre drejt një të ardhmeje më të mirë.

“*Imigrant i parregullt*” i referohet të huajve që kanë hyrë apo qëndrojnë në Shqipëri në mënyrë të parregullt dhe nuk kanë kërkuar azil. Termi *deportiv* përdoret për shtetasit shqiptar (të deportuar pas datës 01 janar 2015), për shkak të masës së ndalimit të hyrjes në zonën Schengen, të regjistruar në sistemin TIMS si të tillë, me arsyetimin “*të mos lejohen të kalojnë kufirin shtetëror, kur ata do të udhëtojnë përsëri me destinacion vendet e Schengenit/BE-së, pa një dokument shkresor që provon se ka një ndalim hyrje, urdhër largimi, ose urdhra dëbimi në ato vende*”. Termi *Inad* i referohet shtetasve shqiptar (të kthyer pas datës 01 janar 2016), për shkak të masës së ndalimit të hyrjes në zonën Schengen, me arsyetimin “për informacion në SIS”, “refuzim azili”, dhe “rrezik për sigurinë publike”. Në vendimin në të cilin përcaktohet klasifikimi i shtetasve INAD është parashikuar: “*të mos lejohen të kalojnë kufirin shtetëror, kur ata do të udhëtojnë përsëri me destinacion vendet e Schengenit/BE-së, pa një dokument shkresor që provon se ka një ndalim hyrje në ato vende*”.

*Apellas*² të dokumentuar në Regjistrin Kombëtar kur kjo masë ka fuqi vetëm për shtetin që e ka dhënë dhe personi mund të lëvizë lirisht në zonën Schengen, si dhe *Apellas* të regjistruar në sistemin SIS kur individi nuk mund të hyjë në asnjë vend të zonës Schengen.

Azilkërkuës i referohemi çdo të huaji apo personi pa shtetësi, që shpreh në çfarëdo lloj mënyre se nuk dëshiron të kthehet në vendin e tij, si dhe çdo të huaji apo personi pa shtetësi që ka paraqitur një aplikim për azil në Republikën e Shqipërisë, për të cilin nuk është marrë ende një vendim përfundimtar. Me termin ‘*refugjat*’ - sipas parashikimeve ligjore duhet kuptuar i huaji apo personi pa shtetësi, i cili, për shkak të frikës së bazuar të persekutimit, për arsye të racës, besimit, kombësisë, anëtarësisë në një grup të caktuar shoqëror ose bindjes politike, ndodhet jashtë vendit të shtetësisë së tij ose vendit të zakonshëm të banimit dhe nuk ka mundësi ose dëshirë për të kërkuar mbrojtjen e atij vendi apo kthimin në atë vend, si pasojë e këtyre rrethanave, në përputhje me kriteret e nenit 1(A) të Konventës së Gjenevës.³

¹Referuar Ligjit Nr. 108/2013 “Për të huajt” (i ndryshuar)

² Ky akt është konstatuar gjatë monitorimeve të realizuara kryesisht në Pikat e Kalimit të Kufirit me shtetin grek

³ Ligj nr. 121/2014 “Për azilin në Republikën e Shqipërisë”.

I mitur i pashoqëruar është i mituri i huaj, i cili hyn në territorin e Republikës së Shqipërisë i pashoqëruar nga një person madhor përgjegjës për të dhe për sa kohë që nuk merret efektivisht në përkujdesje prej tij, ose i mituri që lihet i pashoqëruar, pas hyrjes në territorin e Republikës së Shqipërisë.⁴

⁴Ligj nr. 108/2013 “Për të huajt” dhe Ligj Nr. 121/2014 “Për azilin në Republikën e Shqipërisë”

HYRJE

1.1 Konteksti mbi situatën e fenomenit të migracionit

Lëvizjet migratore, kanë qënë gjithmonë pjesë e historisë së njerëzimit. Por në ditët e sotme, ky fenomen jo vetëm që ka një shtrirje të gjerë, por është edhe shumë kompleks. Konferenca mbi Migracionin e Marakeshit në Marok, në dhjetor të 2018, bashkoi një numër të madh të vendeve, të cilët rikujtuan 70 –vjetorin e Deklaratës Universale të të Drejtave të Njeriut, rast ky për të kujtuar që migrantët gëzojnë të njëjtat të drejtat ashtu si dhe pjesa tjetër e njerëzimit⁵. Pakti për migrantët u firmos nga 160 qeveri të botës.

Për shkaqe të ndryshme si ekonomike, politike, lufta, por edhe ndryshimet klimatike është rritur numri i lëvizjeve migratore dhe sidomos më shumë drejt vendeve të Bashkimit Europian (BE). Kështu, sipas të dhënave të Agjensisë së OKB-së për refugjatët, në vitin 2019 rreth 77,400 emigrantë të parregullt kanë arritur në Evropë përmes Mesdheut, prej të cilëve 45,600 në Greqi, një pjesë në Spanjë, Itali, Maltë dhe Qipron Greke⁶.

Në Raportin e fundit të Komitetit Shqiptar të Helsinkit (KShH) “Mbi të drejtat dhe liritë e emigrantëve, azilkërkuesve dhe refugjatëve në Shqipëri për periudhën 2012-2017”, por edhe në Strategjinë Kombëtare për Qeverisjen e Migracionit dhe Planin i Veprimit 2019 – 2022⁷, tregohet qartë që flukset e përziera migratore kanë prekur dhe Shqipërinë. Kështu flitet për të huaj, refugjatë, azilkërkues, migrantët pa dokumente, viktimë ose viktimë të mundshme të trafikimit, të miturit e pashoqëruar dhe të ndarë, si dhe personat pa shtetësi. Disa prej tyre bëjnë pjesë në më shumë se një nga kategoritë e mësipërme. Këta të huaj kanë shtetësi të ndryshme. Shumica janë sirianë dhe afganë, të cilët hyjnë në territorin e Shqipërisë pa leje hyrjeje. Pjesa më e madhe e këtyre migrantëve gjenden në një situatë të vështirë për shkak të situatës (ekonomike apo politike) në vendet e tyre të origjinës. Një pjesë e tyre kërkojnë azil në vendin tonë, ndërsa pjesa më e madhe e tyre e përdorin territorin shqiptar si vend tranzit për të hyrë në vendet e Bashkimit Evropian, drejt “një jete më të mirë” për veten dhe për familjet e tyre. Sipas raportit vjetor të Komisionit Evropian për vendin tonë të vitit 2019⁸, numri i migrantëve të parregullt që kanë hyrë në Shqipëri dhe që tentojnë të shkojnë drejt vendeve anëtare të BE-së është rritur ndjeshëm në vitin 2018 (5730 në vitin 2018 krahasuar me 1047 në 2017). Grupi më i madh i kësaj kategorie përbëhet nga shtetasit Sirian, të ndjekur nga shtetasit Pakistanez dhe ata Irakien.

Lëvizjet migratore kanë në një masë të gjerë natyrë tranzitore, ku korridori që ndiqet më shumë është ardhja nëpërmjet kufirit me Greqinë dhe lënia e territorit Shqiptar, disa ditë më vonë. Gjithashtu, në këtë raport evidentohet se numri i azilkërkuesve në 2018 është rritur më shumë se me dhjetëfishin, krahasuar me vitin 2017. Në vitin 2018, rreth 4386 individë aplikuan për azil në Shqipëri, krahasuar me 309 kërkesa në 2017. Duke qënë se shumica e azilkërkuesve largohen nga vendi disa ditë më pas, shumica e kërkesave për azil nuk shqyrtohet më tej.

⁵<https://news.un.org/fr/story/2018/12/1031391>

⁶<https://sot.com.al/bota/turqia-dhe-greqia-diskutojne-rreth-krizes-se-migracionit>

⁷<https://konsultimipublik.gov.al/Konsultime/Detaje/116>

⁸<https://ec.europa.eu/neighbourhood-enlargement/sites/near/files/20190529-albania-report.pdf>

Sa i përket emigrimit të parregullt të shqiptarëve në vendet e BE-së, gjatë këtyre 25 viteve të fundit, rreth 33% e popullatës është larguar nga vendi.⁹ Ndërsa, sipas Raportit të publikuar nga Komisioni European (KE) më 19 dhjetor të vitit 2018, rezulton se kanë kaluar kufirin në mënyrë të paligjshme drejt vendeve të BE-së 27% më pak shqiptarë¹⁰. Shteti shqiptar ka respektuar 100% ripranimin dhe kthimin e shtetasve shqiptarë nga vendet e BE-së. Referuar të dhënave të publikuara në Raportin vjetor të KE-së për Shqipërinë për vitin 2019¹¹, vlerësohet se shtetasit shqiptarë përbëjnë grupin më të madh të azilkërkuesve në vendet pa regjim vizash të Ballkanit Perëndimor. Shtetasit Shqiptarë shënojnë numrin më të lartë të personave që qëndrojnë në manyrë të paligjshme ose që hyjnë në mënyrë të paligjshme në vendet e BE-së. Megjithatë, të dhënat krahasuese midis viteve 2017 dhe 2018 tregojnë një rënie të kërkesave për azil me 15%. Franca vijon të jetë shteti kryesor që ka numrin më të lartë të kërkesave për azil nga shtetasit shqiptar, pavarësisht se në krahasim me 2017, viti pasues shënon një ulje me 20% të këtyre kërkesave. Në Gjermani, numri total i kërkesave për azil shënoni një ulje me 52% në 2018. Në 2018-ën, njohja e kërkesave për azil në vendet e BE-së dhe vendet e Shengenit kap nivelin 7.6%.

Lidhur me kontrollin e flukseve migratore të përziera përgjatë rrugës së migrimit të Ballkanit Perëndimor, shteti shqiptar ka vazhduar të forcojë bashkëpunimin e tij operacional me shtetet anëtare të BE-së më të prekura nga migracioni i parregullt nga Shqipëria, duke përfshirë shkëmbimin e informacionit me këto shtete për ndalimet e hyrjes në zonën Shengen. Autoritetet shqiptare kanë bashkëpunuar ngushtësisht me shumicën e shteteve anëtare të BE-së për të adresuar migrimin e parregullt të të miturve të pashoqëruar, lehtësimin e migracionit të rregullt, bashkëpunimin operacional për të adresuar migracionin e parregullt dhe shkëmbimin e informacionit, falsifikimin e dokumenteve dhe fushatat informuese mbi të drejtat dhe detyrimet e udhëtimit.¹² Në vitin 2018, 20,255 shtetasve shqiptarë ju refuzua hyrja për të dalë nga territori shqiptar, në pikat e kalimit të kufirit, krahasuar me 12,175 refuzime në vitin 2017 (pra vërehet një rritje me 59%). Mbikëqyrja e kufijve vlerësohet nga Komisioni Evropian se është intensifikuar për parandalimin e kalimit të paligjshëm të kufirit. Në 2018-ën, 2,158 shtetas shqiptarë u zbuluan teksa kalonin në mënyrë të paligjshme kufirin, pra rreth 24% më shumë se në vitin 2017¹³.

⁹KShH, 2018, *Raportstudimor "Mbi të drejtat dhe liritë e emigrantëve, azilkërkuesve dhe refugjatëve në Shqipëri për periudhën 2012-2017"*.

¹⁰https://ec.europa.eu/home-affairs/sites/homeaffairs/files/ehat-ee-do/policies/european-agenda-migration/20181219_sëd-2018-496-report_en.pdf

¹¹fq 41 e raportit, publikuar në këtë link:

<https://ec.europa.eu/neighbourhood-enlargement/sites/near/files/20190529-albania-report.pdf>

¹²https://ec.europa.eu/neighbourhood-enlargement/sites/near/files/pdf/key_documents/2014/20141008-albania-progress-report_en.pdf

¹³fq 41 e raportit, publikuar në këtë link:

<https://ec.europa.eu/neighbourhood-enlargement/sites/near/files/20190529-albania-report.pdf>

PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE

i. Zbatimi i konventave ndërkombëtare por edhe i legjislacionit vendas, vijon të përbëjë një sfidë të vazhdueshme të autoriteteve shqiptare lidhur me respektimin e standarteve për menaxhimin e kufijve, trajtimin dhe akomodimin në institucionet përkatëse të migrantëve në territorin e vendit tonë. Flukset e migrantëve të huaj në territorin shqiptar mbeten të një natyre tranzit, duke marrë parasysh shumicën dërrmuese të emigrantëve të parregullt dhe azilkërkuesve që largohen nga vendi pas disa ditësh.

ii. Gjatë monitorimeve të kryera nga KShH është vërejtur se Qendra Pritëse e Azilkërkuesve, e cila ka një kapacitet prej 180 personash, ka patur periudha që është përballur me fluks të lartë, duke operuar në kushtet e pritjes mbi kapacitetin e saj maksimal. Kapaciteti aktual pritës në vend, duke përfshirë Qendrën Kombëtare për Azilkërkuesit, si dhe objektet e strehimit të përkohshëm në Gjirokastër dhe Shkodër, është rreth 380 vende. Kapaciteti infrastrukturor dhe i burimeve njerëzore i autoriteteve kompetente në Republikën e Shqipërisë, për të strehuar migrantët e parregullt apo azilkërkuesit, mbetet larg standarteve europiane dhe i pamjaftueshëm për një dyndje më të madhe migrantësh. Gjithashtu, Shqipëria ka nevojë për një monitorim të rreptë të zbatimit në praktikë të garantimit dhe respektimit të të drejtave të migrantëve të huaj dhe shqiptarë.

iii. Në kontekstin e lëvizjeve migratore në vendin tonë, merr një rëndësi thelbësore respektimi i të drejtave të emigrantëve, azilkërkuesve dhe refugjatëve në Shqipëri, si e drejta për akomodim të sigurt dhe të denjë, mbrojtja e fëmijëve, mbrojtja e grave, shëndeti dhe menaxhimi i të dhënave etj.¹⁴

iv. Në përmbushje të misionit të tij, KShH ka monitoruar pikat e kalimit të kufirit dhe institucionet ku akomodohen të huajt, gjatë periudhës Shtator 2018 – Qershor 2019. Nuk është hera e parë që KShH ndërmerr misione monitoruese për të verifikuar situatën në terren të zbatimit sipas ligjeve dhe konventave të migrantëve të parregullt, azilkërkuesve dhe të refugjatëve, në territorin shqiptar. Ky raport analizon në vijim gjetjet e vëzhguesve të KShH-së, mbi respektimin e konventave ndërkombëtare dhe legjislacionit tonë sa i takon të drejtave dhe lirive të migrantëve, azilkërkuesve dhe refugjatëve, procedurat e ndalimit, shoqërimit, akomodimit, intervistimit, përzgjedhjes, plotësimit të shërbimeve bazë të përcaktuara në ligje dhe konventa ndërkombëtare, etj.

v. Zbatimi i urdhërit nr. 805 prot., datë 01.08.2017 i Drejtorit të Përgjithshëm i Policisë së Shtetit në Pikat e Kalimit të Kufirit, i cili ka pasur si qëllim reduktimin e kërkesave për azil nga shtetasit shqiptarë drejt vendeve të BE-së, ka sjellë refuzimin në dalje nga territori të shumë shtetasve shqiptarë, veçanërisht në PKK Rinas. Ky urdhër evidenton një mungesë standardizimi me Ligjin nr. 71/2016, “Për kontrollin kufitar”, si dhe ka sjellë si pasojë situata të tensionuara mes qytetarëve si rezultat i mungesës së njohjes së tij. Gjithashtu, KShH ka vërejtur se, në PKK të Hanit të Hotit, Qafë Morinë, Kapshticë, formati i aktit të “Refuzimit të daljes nga RSH” nuk është i standardizuar dhe unifikuar. Në pikën kufitare të Hanit të Hotit kishte mungesa në

¹⁴Strategjia kombëtare për qeverisjen e migracionit dhe plani i veprimit 2019 - 2022

formularët e “Refuzimit të hyrjes” dhe “Refuzimit të daljes”, ndërsa në PKK Qafë-Morinë formularët tip nuk ishin përcjellë nga organet eprorë, për pasojë ato nuk përdorshin nga punonjësit e kësaj pike.

vi. Gjatë monitorimit në PKK-at Hani i Hotit, Muriqan, Kapshticë, Kakavijë dhe Stacioni i Kufirit Gosë, u vërejtën vakanca në organikë lidhur me pozicionin e efektivëve, të kontrollorit, trupës së shërbimit etj. Problematike vijon të mbetet mungesa e personelit femër në disa institucione të kalimit të kufirit, ku procedurat kryeshin nga punonjës meshkuj në kundërshtim me pikën 1 të Udhëzimit të Përzgjedhjes nr. 293, datë 04.06.2015 “*Mbi procedurat e trajtimit të shtetasve të huaj me qëndrim të parregullt në territorin e Republikës së Shqipërisë*”, lëshuar nga Ministri i Punëve të Brendshme, si dhe Direktivës së Këshillit 2001/55/KE.

vii. Gjithashtu në procesin e intervistimit të personave, janë vërejtur mungesë në stafin psiko – social dhe përkthyes, konkretisht në PKK Hani i Hotit, Muriqan, Qafë-Morinë, Kapshticë, Drejtoria Vendore e Policisë, Migracionit dhe Kufirit – Shkodër, Komisaratin e Policisë Kufitare Rinas, Pika e Kalimit Kufitar Kakavijë dhe Stacioni i Kufirit Gosë, Livadhja si dhe Komisarati i Kufirit dhe Migracionit Sarandë. Ky shërbim sigurohet nga organizatat bashkëpunuese si Caritas dhe UNHCR. Problematika vijon të ketë sa i takon mungesave në personelin e shërbimit mjekësor. Në shumëpikakufitare si PKK Hani i Hotit, Muriqan, Qafë-Morinë, Kapshticë, Komisaratin e Policisë Kufitare Rinas, Stacioni i Policisë Kufitare Livadhja, Komisarati i Kufirit dhe Migracionit Sarandë, mungonte pozicioni i mjekut në organikë. Ky shërbim ofrohet nëpërmjet asistencës së organizatave, si Caritas dhe UNHCR, nëpërmjet spitaleve civile rajonale dhe institucioneve të tjera që i përkasin besimeve të ndryshme fetare.

viii. PKK përballen me vështirësi për sa i përket mungesave në mjetet e transportit dhe mjetet e tjera logjistike, të cilat janë të nevojshme dhe përbëjnë kërkesa minimum për kontrollin dhe menaxhimin efektiv të kufijve. Kështu, rezultojnë mungesa të mjeteve të duhura logjistike si mjete automobilistike, uniforma, elemente teknike dhe të sigurisë, radarë apo kamera termike etj. Gjithashtu rezulton edhe amortizim i tepërt i mjeteve ekzistuese.

ix. Në disa prej PKK-ve të monitoruara u evidentuan problematika në dokumentimin dhe regjistrimin e të dhënave të personave që i nënshtroheshin procedurave të intervistimit apo të kufizimit të përkohshëm të lirisë. Kështu, u konstatuan mungesa në evidentimin e të dhënave në formatin e regjistrave në procedurën e intervistimit të shtetasve të huaj migrantë, si dhe për rastet e shtetasve shqiptarë që bien nën kategoritë INAD/DEPORTIV. Një rast i tillë u konstatua edhe në Stacionin e Kufirit Gosë ku dokumentimi bëhej elektronikisht ndërsa regjistrat nuk ishin të përshtatur me formatet e përcaktuara nga Ministria e Brendshme. Në disa PKK, si ajo e Qafë-Morinës, u konstatua edhe mungesa e fletëpalosjeve informuese mbi të drejtat procedurale që gëzojnë shtetasit azilkërkues e migrantë.

x. Vëzhguesit e KShH-së vërejtën probleme në lidhje me akomodimin, fjetjen, ushqimin dhe ujin e pijshëm, në disa prej ambienteve akomoduese të PKK. Kushtet fizike në disa prej tyre janë të amortizuara, me lagështirë dhe probleme higjeno-sanitare. Gjithashtu, ambientet e akomodimit dhe të intervistimit në disa pika si Livadhja, Kapshticë, Komisarati i Kufirit dhe Migracionit Sarandë, Drejtoria Vendore e Policisë, Migracionit dhe Kufirit në Shkodër, mungonin.

xi. Gjatë monitorimit, KShH është njohur me të dhëna të pjesshme, lidhur me masat administrative dhe dënimet penale të vendosura ndaj shtetasve lidhur me kalimin e kufirit, tejkalimin e afatit ligjor të qëndrimit në territorin e RSH, apo për veprat penale të lidhura me kalimin e paligjshëm të kufirit. Sipas të dhënave të monitorimit, rezultojnë që numri i masave administrative për vitin 2018 të jetë në total 119 ku 108 janë dhënë për shtetasit shqiptarë dhe 11 për ata të huaj.

xii. Gjithashtu, ndaj një kategorie individësh janë dhënë dënime penale për veprat penale të parashikuara në Kodin tonë Penal, përkatësisht në 72 raste, nga të cilat 71 dënime janë dhënë për shqiptarët dhe 1 për të huaj. Përqindjen më të madhe e zënë veprat penale “Falsifikim i vulave, stampave ose i formularëve” (neni 190 KP) me 26%, “Kalim i paligjshëm i kufirit” (neni 297 KP) me 20%, “Falsifikim i dokumentave” (neni 186 KP) me 17%, “Trafikim i lëndëve narkotike” (neni 283/a KP) me 12% dhe “Prodhim, mbajtje dhe shitje të lëndëve narkotike”.

xiii. Ky raport, në vazhdim është i përbërë nga tre pjesë kryesore. Në pjesën e parë është shpjeguar metodologjia e ndjekur për mbledhjen dhe përpunimin e të dhënave dhe gjetjeve të pasqyruara në këtë raport. Në pjesën e dytë, përshkruhen rezultatet e monitorimit të vëzhguesve të KShH-së. Në pjesën e fundit, janë pasqyruar konkluzionet më të rëndësishme të këtij raporti studimor, si dhe rekomandimet drejtuar autoriteteve, me qëllim ofrimin e një kontributi cilësor në përmirësimin e gjendjes së respektimit të të drejtave të imigrantëve të parregullt, azilkërkuesve dhe emigrantëve shqiptarë.

KAPITULLI I

METODOLOGJIA E PËRDORUR NË REALIZIMIN E RAPORTIT

1.1. Metodologjia

Baza kryesore në mbledhjen dhe përpunimin e shumë prej të dhënave të pasqyruara në raport janë verifikimet e kryera nga vëzhguesit e KShH-së, gjatë misioneve të planifikuara në terren të situates së respektimit të të drejtave të azilkërkuesve, refugjatëve, emigrantëve të parregullt dhe të miturve të pashoqëruar. Aksesit i vëzhguesve të KShH-së në PKK-të u mundësua në sajë të Marrëveshjes së Bashkëpunimit të nënshkruar ndërmjet Policisë së Shtetit dhe KShH-së. Pas paraqitjes së autorizimit përkatës për aksesin e nevojshëm në ambiente dhe informacion, është vijuar me grumbullimin e informacionit, me anë të intervistimit të hapur dhe të drejtpërdrejtë të përfaqësuesve të institucioneve, njohjen dhe kqyrjen e dokumentacionit dhe praktikave të mbajtura, si dhe bashkëbisedimin me shtetas të huaj/azilkërkues prezentë në këto institucione. Analiza e të dhënave sasiore u përpunua nga metodat statistikore duke u prezantuar me ndihmën e grafikëve.

Në monitorimet e zhvilluara, grupi i punës është mbështetur në statistikën e ofruara nga personeli përgjegjës në momentin e kryerjes së monitorimit, në informacionet verbale të referuara prej tyre, si dhe në opinionet e ofruara nga vetë të intervistuarit mbi situatën dhe problemet e hasura përgjatë ushtrimit të detyrës. Dokumentacioni me të cilin u njoh grupi i monitorimit përbëhet nga praktikatat e regjistrimeve të migrantëve, si praktikat e mospranimit të hyrjes në kufi, lëshuar nga pala fqinje, si dhe në praktikatat e refuzimit të daljes nga Republika e Shqipërisë.

Gjithashtu, vëzhguesit e KShH-së aksesuan dhe kqyrën ambientet fizike dhe kushtet higjieno – sanitare, në të cilat akomodoheshin migrantët dhe të huajt.

1.2. Zona gjeografike, objekt i këtij studimi

Në total, KShH ka realizuar me anë të vëzhguesve të tij 14 misione monitorimi, përkatësisht në 7 Pikat e Kalimit të Kufirit të RSH (Hani i Hotit, Kakavijë, Kapshticë, Muriqan, Qafethanë, Tushemisht, Qafe Morinë, Morinë), Stacionet e Policisë Kufitare në Livadhja dhe Kapshticë, Drejtori Rajonale si ajo e: Drejtorisë Vendore të Policisë, Migracionit dhe Kufirit – Shkodër, 2 komisariate (Komisariati i Policisë Kufitare Rinas dhe Komisariati i Kufirit dhe Migracionit Sarandë), si dhe Qendra Kombëtare Pritëse Babrru, në Tiranë (figura 1.1).

Vëzhguesit e KShH-së kanë kërkuar të realizojnë monitorim në Qendrën e Mbyllur (Kareç) për të huajt e parregullt në territorin e RSH-së, por një gjë e tillë nuk është realizuar për shkak të refuzimit të hyrjes nga autoritetet përgjegjëse në këtë Qendër.

Figura 1.1. Institucionet kufitare dhe të migracionit të monitoruara nga vëzhguesit e KShH



1.3.Limitet metodologjike

Ky studim ka limitet e tij, pavarësisht nga fakti se është bërë një punë e madhe për të paraqitur sa më realisht situatën e respektimit të të drejtave të migrantëve si dhe problematikën e konstatuar, në territorin shqiptar nga ana e institucioneve përgjegjëse.

Limitet metodologjike që janë hasur dhe që ndikojnë në mungesën e gjithë përfshirjes dhe saktësisë së plotë të të dhënave dhe gjetjeve të pasqyruara në këtë raport janë si vijon:

- Gjatë periudhës së monitorimit ka rezultuar një fluks i ulët personash, përkatësisht, azilkërkues, refugjatë, emigrantë të parregullt dhe të mitur të pashoqëruar. Mungesa e

intervistave me këtë kategori subjektesh e ka kufizuar ekipin e vëzhguesve për të marrë të dhëna të plota lidhur me çështjet që kanë qenë objekt vëzhgimi.

- Jo gjithmonë institucionet janë treguar bashkëpunuese dhe të sinqerta në dhënien e informacionit, si gjatë intervistimit por edhe korrespondencës zyrtare.
- Moslejimi i vëzhguesve të KShH-së për të monitoruar Qendrën e Mbyllur (Kareç) ku janë akomoduar të huajt e parregullt në territorin e RSH-së, gjithashtu ka ndikuar në kufizimin e informacioneve lidhur me këtë kategori, e cila, bazuar në vëzhgimet që KShH ka patur në të kaluarën, ka patur një sërë problematikash sa i takon procedurave, kufizimit të lirisë dhe afateve tepër të gjata që mbaheshin në këtë qendër.

KAPITULLI II


MONITORIMI I TË DREJTAVE TË MIGRANTËVE NË SHQIPËRI

2.1. Të dhëna statistikore për migrantët

2.1.1 Migrantët e ndaluar në hyrje/dalje të kufirit


Duke u bazuar në të dhënat e monitorimit në institucionet e PKK-ve, KShH konstaton se numri total i shtetasve të ndaluar është 2713 persona nga të cilët 331 konstatohen të ndaluar në kufi dhe 2382 të jenë ndaluar nga hyrjet dhe daljet nëpër dogana (figura 2.1).

Figura 2.1. Numri i shtetasve të ndaluar në hyrje-dalje, nga institucionet kufitare, gjatë vitit 2018




Shifra totale prej 331 ndalimesh në kufi dhe 2382 në dogana (figura 2.1) përbëhet nga shtetas shqiptarë dhe shtetas të huaj, të ndaluar për arsye të ndryshme. Kështu, në kufi shifra prej 331 gjithsej, përbën numrin e migrantëve të grupuar ku 21 janë shqiptarë të ndaluar në dalje dhe 310 janë shtetas të huaj të ndaluar në hyrje (figura 2.2). Ndryshe paraqitet situata në dogana. Këtu shohim se ndalimi i përket më shumë shtetasve shqiptarë, përkatësisht 1523 ndalime në hyrje dhe 826 në dalje, ndërkohë që rezultojnë vetëm 33 shtetas të huaj të ndaluar në hyrje dhe asnjë të ndaluar në dalje.

Figura 2.2. Të dhëna të kategorizuara, për shtetasit shqiptarë dhe të huaj, të ndaluar në hyrje-dalje të kufirit dhe doganave prej institucioneve kufitare, për vitin 2018 (figura grafike kombinon hyrjet dhe daljet në kufi dhe doganë, duke alternuar të dhënat për shtetasit shqiptarë me ata të huaj).



Kategorizimi i të dhënave të shtetasve të ndaluar, evidenton se ka patur 2370 ndalime ndaj shtetasve shqiptarë (ku 1523 persona janë ndaluar në hyrje dhe 847 në dalje të kufirit (figura 2.3), ndërsa shtetasve të huaj, vërehet se në dalje nuk kemi ndalim, ndërkohë që në hyrje ka 343 ndalime në total (ku 310 persona janë ndaluar në kufi dhe 33 në dogana).

Figura 2.3. Numri i shtetasve të kategorizuar në shqiptarë dhe të huaj, të ndaluar në hyrje-dalje të kufirit dhe doganave prej institucionet kufitare, për vitin 2018 (figura grafike kombinon hyrjet dhe daljet në kufi dhe doganë, fillimisht për shtetasit shqiptarë dhe më pas për ata të huaj)




2.1.1.1. Shtetasit shqiptarë/huaj sipas profilit të ndalimit në kufi dhe dogana

Bazuar në të dhënat e vëna në dispozicion nga institucionet e kufirit, vërehet një numër i madh shkaqesh për të cilat janë ndaluar shtetasit shqiptarë në kufi dhe dogana (figura 2.4). Kështu, në PKK Qafë-Morinë ka një fluks të madh hyrje-daljesh, për shkak edhe të kufizimit me Kosovën. Sipas statistikave të vëna në dispozicion rezulton se hyrje-daljet për shtetasit shqiptarë të jenë mesatarisht rreth 110 000 veta, ndërsa për të huajt mesatarisht 50000 veta (tabela, aneks). Nga informacioni statistikor i marrë nga kjo PKK për 6 mujorin e parë, Janar – Qershor të vitit 2018, rezulton se janë kontrolluar 8362 shtetas dhe mjete në vijën e parë dhe 720 kontrolle të shtetasve dhe mjeteve në vijën e dytë. Nga këta persona rezultojnë të ndaluar 124 persona, të dhënat e të cilave kategorizohen si vijon:

- 4 persona shqiptarë në kërkim kombëtar;
- 13 persona të kapur në kërkim për llogari të Kosovës;
- 1 person i kapur në kërkim ndërkombëtar;
- 94 shtetas të kontrolluar si të dyshuar;
- 9 shtetas të prapësuar, pasi ishin të deportuar nga vendet e Schengen-it;
- 3 shtetas të prapësuar në hyrje;

Në stacionin e Kufirit Gosë dhe në PKK Kakavijë, si rrjedhojë e planit operacional DRINO, realizuar në kuadër të bashkëpunimit rajonal me fqinjët, janë identifikuar 36 shtetas, nga të cilët 21 shtetas shqiptarë të cilët kishin tentuar të kalonin kufirin në mënyrë të kundërligjshme.

Figura 2.4. Shkaqet e ndalimit në hyrje-dalje të kufirit dhe doganave prej institucioneve kufitare për shtetasit shqiptarë, për vitin 2018



Përveç shqiptarëve të ndaluar për kalim të paligjshëm të kufirit kemi edhe një kategori tjetër që konsiderohen të parregullt për shkaqe të mos plotësimit të kushteve për kalim të rregullt të kufirit. Konkretisht, përfaqësues të PKK Qafë Thanë referuan se për periudhën Janar – Gusht 2018, u është refuzuar dalja nga RSH gjithsej 826 shtetasve shqiptarë. Ndalimi është bazuar në Urdhërin nr. 805 datë 01.08.2017, lëshuar nga Drejtori i Përgjithshëm i Policisë së Shtetit, i cili ka pasur si qëllim reduktimin e kërkesave për azil nga shtetasit shqiptarë drejt vendeve të BE-së. Arsyet e refuzimit të daljes për këta persona janë: 24 shtetas nuk kanë justifikuar dot qëllimin e udhëtimit; 31 shtetas për mungesë të deklaratës noteriale për të shoqëruar të miturit ndërsa 10 shtetas për arsye të tjera. Në të gjitha PKK-të e monitoruara, rezulton se ky urdhër ka krijuar mjaft shqetësim tek qytetarët, duke e konsideruar si kufizim të lirisë së tyre të lëvizjes.

Në kategorinë e shtetasve shqiptarë që konsiderohen të parregullt, përfshihet edhe kategoria e individëve DEPORTIV. KShH konstatoi se PKK Qafë Thanë ka ndaluar në hyrje 205 shtetas të kthyer në këtë kategori nga ana e palës maqedonase, prej të cilëve, 179 shtetas janë kthyer për punësim të parregullt në Maqedoni, 4 shtetas janë kthyer pasi kanë vuajtur dënimin me burg në Maqedoni dhe 22 shtetas për arsye të tjera. Këta shtetas sillen nga ana e palës maqedonase me letër shoqëruese, përkatësisht në shumicën e rasteve me lista përkatëse. Gjithashtu, referuar të dhënave të marra nga analizat e riskut, të vëna në dispozicion nga ana e SPK-së Kapshticë, rezulton se 992 shtetas shqiptarë janë kthyer në mënyrë vullnetare dhe me forcë në kategorinë DEPORTIV. Nga këto, 631 shtetas janë kthyer për arsye qëndrimi të parregullt në mungesë të dokumenteve të udhëtimit apo identifikimit në vendet e BE-së, ose qëndrim ilegal në këto vende; ndaj 74 shtetasve është vendosur Apellas (të konsideruar si shtetas që përbëjnë kërcënim për rendin dhe sigurinë publike); 36 shtetas janë të deportuar pasi ka kryer dënim me burg në Greqi dhe 251 persona për arsye të tjera (figura 2.4).


Përveç kategorisë DEPORTIV kemi edhe kategorinë INAD. KShH konstaton se në PKK Qafë Thanë, janë kthyer 30 shtetas të kategorisë INAD. Nga monitorimi i realizuar është vërejtur se arsyet e prapësimit kanë qenë: 5 shtetas kanë patur dokument të dëmtuar udhëtimi, 3 shtetas nuk kanë justifikuar qëllimin e udhëtimit, 1 shtetas është konsideruar si person i padëshiruar në regjistrin kombëtar dhe 21 shtetas për arsye të tjera (figura 2.4). Ndërsa në PKK Kapshticë, KShH konstatoi se nga ana e palës greke janë prapësuar 2195 shtetas, nga të cilët: 330 prej tyre me arsyen se nuk disponojnë mjete të mjaftueshme jetese në lidhje me qëndrimin dhe rikthimin e tyre; 182 shtetas kanë shkelur afatet e qëndrimit në zonën Schengen; 6 shtetas për arsye të tjera dhe 8 shtetas për dokumenta false.

Ashtu si për shtetasit shqiptarë, edhe për shtetasit e huaj, statistikën e ndalimit në kufi dhe nëpër dogana janë dhënë të limituara nga ana e institucioneve të kufirit, të monitoruara nga KShH. Përfaqësues të PKK-ve Qafë Morinë dhe Tushemisht, kanë pohuar se nuk kanë patur raste të ndalimit të shtetasve të huaj, qoftë azilkërkues apo migrantë të parregullt që kanë hyrë në territorin që ndodhet nën juridiksionin e tyre. Në PKK Qafë Morinë, mungesa e numrit të azilkërkuesve dhe migrantëve të parregullt, ka ardhur edhe si pasojë e mungesës së kufirit me shtete të tjera europiane. Sipas përfaqësuesve të kësaj PKK-je, kalimi në këtë pikë shfrytëzohet nga punëtorët stinorë, pasi gjatë stinës së verës është vërejtur një fluks i shtuar, kryesisht i shtetasve kosovarë drejt Shqipërisë. Të njëjtin qëndrim kanë referuar edhe përfaqësuesit e PKK Tushemisht. Sipas tyre, mungesa e numrit të azilkërkuesve dhe migrantëve të parregullt, vinte si pasojë e mungesës së kufirit me Greqinë. Gjithashtu, në këtë pjesë të kufirit territorial rezultoi se nuk ka pasur asnjë rast të miturve të pashoqëruar, por nëse do të përballeshin me një rast të tillë do t'i dërgonin pranë psikologut të Bashkisë Pogradec.

Vëzhguesit e KShH-së konstatuan mungesë të unifikimit të praktikave pranë PKK-ve të monitoruara. Në bazë të informacionit të dhënë nga pikat e tjera të kalimit të kufirit, vërehet se janë ndaluar shumë migrantë të huaj të parregullt për shkaqe dhe arsye të ndryshme (figura 2.5).

Në SPK Livadhja, monitoruesit e KShH-së u informuan se në rastet e kalimit të shtetasve të huaj, punonjësit e këtij stacioni policor kufitar i shoqëronin shtetasit në PKK Qafë Botë ose në Kakavijë.

Figura 2.5. Shkaqet e ndalimit në hyrje-dalje të kufirit dhe doganave prej institucioneve kufitare për shtetasit e huaj, për vitin 2018



Sipas stafit të SPK Kapshticë, fenomeni i kalimit të paligjshëm të kufirit nga shtetas të huaj, të ardhur nga vendet arabe ka qenë evident gjatë muajit Prill 2018 dhe vazhdon të vërehet një rritje e fluksit. Itinerari i përdorur nga ana e tyre është nëpërmjet ardhjes nga shteti grek, në drejtim të Terstenikut. Punonjësit deklaruan se nuk ishin konstatuar shtetas shqiptarë, në rolin e ndihmësve për kalimin e paligjshëm të kufirit shtetëror. Referuar të dhënave të marra nga analizat e riskut, të vëna në dispozicion nga ky stacion për 6 mujorin e parë të vitit 2018, rezulton se janë kapur në territorin e RSH-së, 212 shtetas të huaj të parregullt (me fluks më të lartë në muajin Qershor 2018 me 99 shtetas). **Nga këta shtetas, rreth 75% e tyre ose 157 kanë kërkuar azil dhe janë dërguar në Qendrën Pritëse në Babrru.** Ndërsa ndaj 55 shtetasve është vendosur “Urdhër largimi vullnetar”, në përputhje me nenin 106 e vijues të ligjit nr. 108/2013 “Për të huajt” (i ndryshuar).

Gjithashtu, pas njohjes me regjistrin e evidentimit të të dhënave për personat e shoqëruar pranë SPK Gosë, të plotësuar që nga data 3 Shkurt 2018, KShH konstatoi se në territorin e vendit tonë në mënyrë të kundërligjshme, kanë hyrë 25 persona të huaj, të cilët kanë qenë të shoqëruar.

E ndryshme paraqitet situata në KKM Sarandë. Sipas përfaqësuesve të këtij Komisariati, në këtë institucion nuk kishte pasur asnjë rast të femrave të pashoqëruara. Ndërsa përsa i përket të miturve të pashoqëruar, janë vërejtur raste të rralla, ku gjatë 2 viteve rezultojnë të dokumentuara vetëm 3-4 raste. Gjithashtu, në 6 mujorin e parë të vitit 2018, vëzhguesit e KShH-së u informuan se 47 persona i janë nënshtruar procedurës së përzgjedhjes. Nga ky grup, 44 shtetas kanë kërkuar azil, për këtë qëllim janë dërguar në Qendrën Pritëse në Babrru (Tiranë). 38 prej tyre vinin nga Siria dhe Pakistani. P.sh.: në përbërjen e këtij grupi janë konstatuar 9 shtetas të mitur, por të gjithë kishin qenë të shoqëruar nga familjarët e tyre. Ndaj 3 pjesëtarëve të këtij grupi, 2 prej të cilëve janë shtetas rusë është vendosur “Urdhër largimi vullnetar”. Nga bashkëbisedimi i realizuar, përfaqësuesit e KKM Sarandë konfirmojnë se nuk ishin përballur me asnjë rast të emigrantëve apo azilkërkuesve viktimë apo viktimë të mundshme të trafikimit.

Përsa i përket shtetasve të huaj të kapur në doganë, numri i tyre paraqitet i vogël. Nga ana e vëzhguesve të KShH-së, në KPK Rinas, nuk u vërejt asnjë praktikë e refuzimit të hyrjes së shtetasve në Republikën e Shqipërisë. Ndërsa në PKK Tushemisht rezultoi se 1 shtetas nga

Kazakistani ishte kthyer INAD nga ana e palës maqedonase, pasi nuk dispononte vizë të vlefshme. Pas njohjes me vendimin e lëshuar nga autoriteti kompetent, u konstatua referimi i ligjit “Për të huajt” nr. 35/2006 dhe nr. 66/2007, parag. 1 të Republikës Maqedonase, në cilësinë e bazës ligjore. Ndërkohë, KShH konstatoi se formati “Refuzim Hyrje” ka të parashikuar qartësisht edhe arsyet përse shtetasi nuk mund të hyjë në kufirin e RSH-së, në përputhje me Ligjin nr. 108/2013, dt. 28.03.2013. Gjatë monitorimit u vërejt se vetëm 2 persona nuk janë lejuar që të hyjnë në Republikën e Shqipërisë. Arsyet e ndalimit të hyrjes së këtyre 2 shtetasve të huaj në territorin shqiptar, nëpërmjet PKK Kapshticë, rezultojnë të jenë dyshimet për përfshirjen e tyre në kontrabandë apo trafik të lëndëve narkotike. Nga të dhënat e dokumentuara në analizën e riskut të kësaj PKK-je, rezulton se janë ushtruar gjithsej 18,633 kontrole për përzgjedhje në vijën e dytë, dhe si rezultat i kontroleve është bërë i mundur identifikimi dhe arrestimi i 5 shtetasve të shpallur në kërkim ndërkombëtar për trafikim të lëndëve, si dhe shoqërimi i 4 shtetasve të huaj nga vendet e treta, të gjetur të fshehur në kamion. Edhe në PKK Qafë Thanë, vëzhguesit e KShH-së u vunë në dijeni se ju është refuzuar hyrja në Republikën e Shqipërisë, 4 shtetasve të huaj, pasi 2 prej tyre nuk kanë qenë të pajisur me vizë të vlefshme dhe 2 shtetas maqedonas kanë pasur dokument të dëmtuar udhëtimi. Në këtë institucion është mundësuar edhe arrestimi i 17 shtetasve, të cilët kanë qenë të shpallur në kërkim ndërkombëtar nga ana e INTERPOL.


Gjatë monitorimeve të realizuara në PKK është vërejtur edhe një profil tjetër emigrantësh që disponojnë dokumenta të rregullta udhëtimi, të cilët e përdorin territorin shqiptar, për të kaluar në mënyrë të paligjshme, si vend tranziti. I tillë është rasti në PKK Kakavijë, ku konstatohet se shumë shtetas të huaj të ardhur nga Nepali, kanë tentuar të hyjnë në RSH në mënyrë të paligjshme. Sipas përfaqësuesve të kësaj PKK-je, vendi ynë përzgjidhej nga ana e tyre si një vend tranzit, pasi ata synonin që të kalonin më tej drejt Malit të Zi. Shumica e këtyre shtetasve rezultojnë se janë pajisur me leje qëndrimi nga vendi fqinj, Greqia.

2.1.1.2. Masat ligjore: administrative dhe penale

Ligji nr. 71/2016 “Për Policinë Kufitare” ka parashikur dhënien e masave administrative me “gjobë” në momentin që konstatohen kundravajtje apo kalim i paligjshëm i kufirit, ndërsa ligji nr. 108, dt. 28.03.2015, Ligji “Për të huajt”, neni 145, pika 1 (ç), parashikon “gjobë” për të gjithë shtetasit e huaj që kanë shkelur afatet e qëndrimit.

Gjatë monitorimit, KShH është njohur me problemet që hasin shtetasit shqiptarë dhe të huaj ndaj masave administrative dhe penale të vendosura për këtë periudhë, qoftë në kalimin kufitar, qoftë edhe në tejkalimin e afatit ligjor të qëndrimit në territorin e RSH. Sipas të dhënave të monitorimit nga vëzhguesit e KShH në terren, rezulton që numri i masave administrative për vitin 2018 të jetë në total 119 ku 108 janë dhënë për shtetasit shqiptarë dhe 11 për ata të huaj (statistikat e ilustruara në figurën 2.6).

Figura 2. 6. Numri i masave administrative dhe penale për shqiptarët dhe të huajt, në RSH, të dhëna nga PKK dhe KKM, për vitin 2018




Gjithashtu, ndaj një kategorie janë dhënë dënime penale, përkatësisht në 72 raste, nga të cilat 71 dënime janë dhënë për shqiptarët dhe 1 për të huaj.

a. Masa administrative sipas PKK dhe problemet e shfaqura

Duke i analizuar sipas PKK, vëzhguesit e KShH konstatuan se në PKK Qafë Thanë janë dhënë 35 masa administrative ndaj shtetasve shqiptarë të deportuar që kanë kaluar në mënyrë të paligjshme kufirin (figura 2.7). Masat e gjobave të vendosura ishin 100.000 – 500.000 lekë, ndërkohë që në pjesën më të madhe të rasteve është aplikuar masa prej 200.000 lekë. Ndërsa në Pikën e Kalimit Kufitar Kapshticë, për shtetasit shqiptarë, janë dhënë 71 masa administrative “gjobë”.

Figura 2.7. Numri i masave administrative për shqiptarët dhe të huajt, në PKK-të e monitoruara nga KShH, për vitin 2018



Për shtetasit e huaj, këto masa janë në një numër më të vogël. Kështu, në PKK Kapshticë, KShH konstatoi se masa administrative “gjobë” është vendosur ndaj 10 shtetasve të huaj. Në PKK Tushemisht, vëzhguesit e KShH-së, pasi u njohën me praktikën e procesverbaleve të konstatimit të kundërvajtjes, konstatuan rastin e 1 shtetasi italian, i cili kishte shkelur afatet e qëndrimit, në

bazë të Ligjit nr. 108, dt. 28.03.2015, Ligji “Për të huajt”, neni 145, pika 1 (ç). Këtij shtetasi i ishte dhënë dënimi administrativ me gjobë në vlerën 100.000 lekë. Përjashtim në këtë rast, bëhej vetëm ndaj shtetasve amerikanë, të cilët gëzonin të drejtën për të qëndruar 1 vit në territorin e vendit tonë. Masat administrative ndaj shtetasve të huaj, të vendosura në këtë pikë kufitare varionin në vlerat midis 200.000 – 300.000 lekë, dhe në rastet e tejkalimit të afateve të qëndrimit në shumën 500.000 lekë.

Në Komisariatit e Kufirit dhe Migracionit Sarandë, vëzhguesit e KShH-së u njohën me praktikën e ndjekur në rastin e lëshimit të urdhërit të ndalimit ndaj dy shtetasve rusë, të cilët kishin qëndruar në territorin shqiptar në mënyrë të parregullt. Këta shtetas kishin hyrë në mënyrë të rregullt në territorin e RSH-së, por kishin tejkaluar afatin 30 ditor të qëndrimit. Fillimisht, ndaj këtyre shtetasve ishte vendosur një gjobë (sanksion administrativ) në masën 100.000 lekë dhe më pas ishin lënë të lirë, pasi kishin deklaruar se do të largoheshin vullnetarisht nga vendi ynë. Procedura e përzgjedhjes së këtyre shtetasve ishte realizuar në prezencë të përfaqësuesve të Shërbimit Informativ Shtetëror (SHIS) dhe Sektorit të Hetimit të Komisariatit të Kufirit e Migracionit Sarandë. Në praktikën e verifikuar në këtë rast rezultonte i përfshirë raporti i shërbimit dhe formulari i përzgjedhjes. Në vijim, ishte proceduar me lëshimin e urdhërit të ndalimit dhe akomodimin e këtyre personave në Qendrën e Mbyllur Kareç.

Nga monitorimet e realizuara, vëzhguesit e KShH-së konstatuan se në PKK Qafë-Morinë, Kakavijë dhe Tushemisht janë vendosur masa administrative, ndaj të cilave u vërejtën disa parregullsi procedurale. Për shembull, në PKK Qafë-Morinë, KShH konstatoi se ekzistonte një bllok, në të cilin ishte evidentuar vetëm një gjobë, në vlerën 1000 Lek, e dhënë me datën 23.06.2018. Kjo masë administrative, rezultonte e nënshkruar nga ana e shtetasit, por në procesverbalin e konstatimit të kundravajtjes bazuar në Ligjin nr. 71/2016 “Për Policinë Kufitare”, neni 13, pika 2/e, u vërejt mungesa e reflektimit të të drejtës së ankimit që shtetasit i njihet në bazën të ligjit, afatin dhe institucionet tek të cilat duhet të drejtohet sipas Kodit të Procedurave Administrative (KPA). E njëjta situatë u konstatua edhe në PKK Kakavijë. Shtetasi nuk mund të ushtronte të drejtën e një ankimi efektiv në përputhje me KPA për shkak se mungonte vendimi i zbardhur, në momentin e dhënies së masës administrative “gjobë”. Ndërsa në Pikën e Kalimit Kufitar Tushemisht, vëzhguesit e KShH-së, konstatuan se procesverbali nuk parashikonte dispozitën konkrete, por vetëm ligjin nr. 71, datë 07.07.2016. Nga stafi i PKK Tushemisht, u informuam se shtetasit janë lejuar të kalojnë edhe pa likujduar gjobën. Kjo gjobë parashkruhej brenda afatit 2 vjeçar. Në raport me dispozitat e ligjit para ndryshimeve, tashmë marzhi i gjobës ishte më i arsyeshëm dhe proporcional.


Gjatë monitorimit, vëzhguesit e KShH-së patën vështirësi për të marrë informacione të natyrës statistikore lidhur me masat administrative. Kështu psh, grupit vëzhgues të KShH-së në DVPMK Shkodër, nuk i'u dha akses në praktikat që përpilohen nga ana e institucionit dhe as statistikatat përkatëse lidhur me numrin e masave të dhëna për kundërvajtjet administrative.

b. Dënimet penale sipas PKK-ve dhe problemet e shfaqura

Ndaj shtetasve shqiptarë që kanë tentuar të kalojnë ose kaluar efektivisht kufirin, vërehet se janë dhënë 72 dënime penale, ku përqindjen më të madhe e zënë “Falsifikim i vulave, stampave ose i formularëve” (neni 190 KP) me 26%, “Kalim i paligjshëm i kufirit” (neni 297 KP) me 20%,

“Falsifikim i dokumentave” (neni 186 KP) me 17%, “Trafikim i lëndëve narkotike” (neni 283/a KP) me 12% dhe “Prodhim, mbajtje dhe shitje të lëndëve narkotike” (neni 283/1 K.P) me 8% (figura 2.8). Dënimet për veprat e tjera penale janë pasqyruar në figurën grafike në vijim dhe zënë 1-3% të dënimeve.

Figura 2. 7. Kategorizimi i veprave penale të dënuara penalisht, të lidhura me kalimin e kufirit për vitin 2018



Bazuar në të dhënat e vëzhguesve të KShH-së gjatë intervistave të tyre në terren, rezulton se shtetasit shqiptarë kanë informacion të kufizuar lidhur me dënimet penale. Sa i takon procedimeve penale, nga Analiza e Riskut e vënë në dispozicion nga stafi i PKK Kapshticë, vërehet se për periudhën Janar – Qershor 2018, janë evidentuar 40 procedime penale, nga të cilat, 17 prej tyre janë proceduar, pasi janë kapur në kufirin e gjelbër duke kaluar në mënyrë të paligjshme kufirin (neni 297 KP).

DVPMK Shkodër informoi vëzhguesit e KShH-së, se gjatë vitit 2018, vërehej një shtim i emigrantëve nga vendet e treta, të cilët vinin kryesisht nga Tirana dhe drejtoheshin për të dalë drejt PKK së Muriqanit. Gjithsesi, asnjë shtetas nga vendet e 3-ta nuk ishte proceduar penalisht, përveç rastit të një shtetasi turk, i proceduar penalisht për veprën penale të “Falsifikimit të dokumentave”.

Në KKM Sarandë, në asnjë rast të personave që kishin kaluar kufirin në mënyrë të kundërligjshme nuk kishte pasur procedim penal ndaj tyre. I njëjti konstatim vlen edhe për shtetasit shqiptar që kanë kaluar në mënyrë të paligjshme PKK e Tushemishtit. Kryesisht, autorët e kësaj kundërvajtjeje penale janë shtetas që zgjedhin rrugën tokësore për të arritur në Shkup, pasi nëpërmjet aeroportit të Shkupit, ata tentojnë të largohen drejt Gjermanisë¹⁵.

Gjatë misionëve të monitorimit, vëzhguesit e KShH-së patën probleme lidhur me aksesin në statistikat për dënimet penale. Kështu, në DVPMK Shkodër, vëzhguesve të KShH-së nuk ju

¹⁵Për vitin 2018, ishin konstatuar vetëm 2 shtetas, përkatësisht 1 në muajin Janar dhe 1 shtetas tjetër në Korrik.

mundësuan praktikat që përpilohen nga ana e institucionit dhe as statistikat përkatëse lidhur me dënueshmërinë penale.

2.1.2. Azilkërkuesit në Qendrën Kombëtare Pritëse në Babrru (Tiranë)

Në Qendrën Kombëtare Pritëse u vërejt një rritje e numrit të shtetasve të regjistruar si azilkërkues. Kështu nga viti 2017 deri në 2018, numri i azilkërkuesve të regjistruar është rritur ndjeshëm, nga 308 në 4371 (figura 2. 10). Numri paraqet tendenca rritje edhe gjatë 2019-ës, ku vetëm në 5-mujorin e parë të tij numri ka shkuar në 2179 azilkërkues.

Figura 2. 8. Statistika mbi azilkërkuesit e regjistruar në Qendrën Kombëtare Pritëse për periudhën 2017-2019






Figura 2. 9. Kategorizimi i azilkërkuesve në Qendra Kombëtare Pritëse sipas strukturës moshore dhe gjinore, për periudhën Janar – Maj 2019



Për vitin 2019, nga 2179 azilkërkues në total, 386 janë minoren dhe 1793 të rritur. Nga minorenët, 146 janë të gjinisë femër dhe 240 meshkuj. Shumica dërmuese të miturve azilkërkues kanë qenë të pashoqëruar, përkatësisht 350 ndërkohë që një minorancë rezultojnë të shoqëruar, përkatësisht 36 prej tyre. Shumica dërmuese e të rriturve janë të gjinisë meshkuj, përkatësisht 1603 ndërkohë që 190 janë femra (figura 2.11).

Azilkërkuesit e akomoduar në këtë qendër në periudhën Janar – Maj 2019 vijnë kryesisht nga vendet e Mesdheut, ku shumicën dërmuese të familjeve e zënë Irakienët, të pasuar nga Sirianët, Palestinezët, etj (figura 2.12).

Figura 2. 10. Statistika mbi origjinën e familjeve që kanë kërkuar azil, në periudhën Janar – Maj 2019



Gjithashtu, referuar statistikave të kësaj qendre për periudhën janar-maj 2019, rezultojnë të rikthyer 509 vetë.

2.2. Monitorimi i respektimit të të drejtave të migrantëve të ndaluar në institucionet e kufirit dhe migracionit

KShH konstaton se garantimi dhe respektimi i të drejtave të migrantëve në PKK dhe SPK bëhet i vështirë, për shkak të disa problematikave që lidhen kryesisht me numrin e ulët të punonjësve të angazhuar në këto pika, vakancave në organikë si dhe nevojave të vazhdueshme për trajnimin profesional të tyre, veçanërisht për standartet e të drejtave të njeriut. Puna e tyre bëhet edhe më e vështirë, pasi ky numër i kufizuar punonjësish operojnë në një terren të vështirë fizik, me mjete të kufizuara logjistike dhe financiare në dispozicion. Këto mangësi të vërejtura në disa prej monitorimeve kanë vështirësuar procesin e kontrollit, identifikimit, intervistimit, në këto pika dhe stacione kufitare.


2.2.1. Organika institucionale e personelit

2.2.1.1. Vakanca në personelin për kontrollin në kufi e dogana

Një prej faktorëve të rëndësishëm që ndikon në kontrollin efikas të vijës kufitare dhe në pikat doganore, është edhe numri i kufizuar i personelit. KShH konstatoi se PKK-të dhe SPK-të e monitoruara mbulojnë një hapësirë gjeografike të konsiderueshme, tokësore dhe ujore ku përfshihen liqenet, lumenjtë dhe ujrat detare (figura 2.13). Përveç KPK Rinas, i cili ushtron kompetencën territoriale vetëm në zonën e Aeroportit Nënë Tereza (terminali) dhe pjesa e kargove, në total, nga PKK-të e tjera mbikqyrret afërsisht 500 km vijë kufitare. Kapacitetet njerëzore të alokuara për këto pika, duke përfshirë SPK janë të mjaftueshme. Në disa pika, hapësira gjeografike karakterizohet nga terreni i thepisur, tepër i vështirë për tu mbikqyrur nga stafi policor.

Kështu, PKK Hani i Hotit ka nën juridiksionin e saj doganën dhe terminalin prej 500 m ku përpunohen mallrat, si dhe përfshin 20 km kufi i gjelbër tokësor dhe ujor. Vakancat e konstatuara në stafin e vijës së parë (pika e kontrollove) menaxhoheshin nëpërmjet ushtrimit të detyrës me orë të zgjatura nga stafi aktual. Në këtë pikë u referuan raste kur punonjësve u është dashur që gjatë ditës të punonin me 3 turne, ndërkohë gjatë natës me 2 turne. Edhe PKK Muriqan e cila mbulon kufirin e gjelbër tokësor, detar dhe liqenor, në gjatësinë kufitare afërsisht prej 32 km, reflekton vakancë në masën 30% të organikës së miratuar institucionale. Këto vakanca vërehen kryesisht në pozicione të kontrollorëve, trupave të shërbimit etj. KShH konstatoi se në total ushtronin funksionin 37 punonjës të cilët duhet të mbulonin 5 sportele, si dhe monitorimin e kufirit të gjelbër. Gjatë sezoneve turistike, përfaqësues të kësaj pike pohuan se kjo organikë nuk mund të përballonte flukset e larta të kalimit të qytetarëve, pavarësisht faktit se ata kishin vepruar me 7 trupa shërbimi (të kategorizuar në turne). Ndërkohë monitorimi i kufirit të gjelbër realizohet vetëm nga 1 patrullë, çka konsiderohet e pamjaftueshme për një pikë me rëndësi dhe përdorim të shpeshtë nga qytetarët.


Figura 2. 11. Shtrirja gjeografike e kontrollit të kufirit nga PKK dhe SPK të monitoruara nga KShH



Në kufirin me Kosovën, PKK Qafë-Morinë mbikqyr një vijë tokësore, në të cilën përfshihej edhe kufiri i gjelbër prej 82 km. Sipas përfaqësuesve të kësaj PKK, kontrolli i kufirit të gjelbër, ishte i vështirë për shkak të terrenit malor, edhe pse numri i personelit ishte 40 punonjës.

I njëjti problem vërehet edhe për organikën e personelit të PKK Qafë-Thanë (figura 2.14). Sipas informacionit të referuar nga përfaqësues të kësaj PKK, edhe pse janë të punësuar 42 punonjës, në organikën e kësaj pike është e domosdoshme shtimi i numrit të tyre për të përballuar siç duhet ngarkesën. KShH konstatoi se në organikë kishte vakancë 2 përgjegjës turni dhe në këto kushte, situatë zgjidhej nëpërmjet punës me orë të zgjatura të stafit ekzistues.

Figura 2. 12. Burimet njerëzore në funksion të kontrollit të kufirit nga PKK dhe SPK



Edhe në PKK Tushemisht, KShH konstatoi vakanca të stafit. PKK Tushemisht mbikqyr në total 40 km, nga e cila 24 km përfshin vijën blu dhe 16 km përbëhet nga vendkalim. Organika e këtij institucioni përbëhet nga 41 punonjës me uniformë. Ndërsa në kontrollin e pikës doganore, në raport me palën maqedonase, evidentohen mungesa, pasi në 1 sportel me 2 drejtime qëndronte vetëm 1 punonjës. Këto mangësi nuk ofrojnë garanci për menaxhimin e duhur të flukseve të lëvizjeve, në periudha të caktuara kohore. Kontrolli i kufirit tokësor patullohej me këmbë nga

personeli, por kishte raste që patrullimi bëhej me automjete. Kjo PKK e shtrin juridiksionin e saj deri në Malin e Thatë, ndërkohë që kufiri tokësor me shtetin Maqedonas është shumë i thyer.

Në kufirin me shtetin grek, SPK Kapshticë monitoron në total 66 km vijë kufitare, nga të cilat 57 km janë në vijë tokësore, 8 km terren lumor dhe 1 km terren liqenor. Edhe në SPK Kapshticë, kontrolli i vijës kufitare ishte tepër i vështirë për shkak të terrenit tepër të thyer malor. Organika e SPK Kapshticë përbëhet nga 41 persona dhe kontrollet e vijës kufitare kryheshin vetëm nga një patrullë me dy efektivë të gjinisë mashkullore, nga 3 patrulla të planifikuara për të ushtruar këtë funksion. Pjesa e mbetur e kufirit, duke ju drejtuar juglindjes, po në kufi me Greqinë, menaxhohet nga PKK Kakavijë dhe SPK të Gosë dhe Livadhja (32 km) dhe mbulon gjithashtu një vijë kufitare të konsiderueshme (figura 3.8). Edhe në Stacionin e Kufirit Gosë të përbërë prej një organike prej 18 personash, përfaqësuesit e SK pohojnë se ky numër personeli ishte i pamjaftueshëm në raport me gjatësinë prej 27 km të kufirit të gjelbër nën juridiksionin e tyre. Momentalisht, për 1 km të kufirit të gjelbër, monitoronin 3 deri në 5 policë. Në Stacionin e Policisë Kufitare Livadhja, shefi i stacionit pohon se organika përbëhej nga 22 persona, ndërkohë që aktualisht ushtronin funksionin 20 punonjës.


Kjo problematikë shfaqet edhe në KPK Rinas (figura 3.9). Përfaqësues të Komisariatit të kësaj pike pohojnë se pavarësisht stafit prej 54 personash, janë adresuar një sërë kërkesash me qëllim shtimin e organikës për shkak se përpunimi i të dhënave të pasagjerëve që kalojnë në vijën e parë është në rritje. Për stafin aktual, kjo është një situatë e papërballueshme dhe ndaj ata punojnë me orë të zgjatura, përtej orarit zyrtar, 40 orë/javë. Në raste fluksesh është zbatuar urdhëri i dhënë për mos lejimin e lejeve të zakonshme vjetore për punonjësit, element i cili është kompensuar më pas. Stafi i këtij komisarati është trajnuar për të drejtat dhe liritë e njeriut, në mënyrë të veçantë të azilkërkuesve, duke marrë pjesë në trajnime nga FRONTEX. Në mbështetje të këtij institucioni gjendeshin 2 seksione emigracioni për Drejtoritë Rajonale, tek të cilat ushtronin funksionin 4 specialistë hetimi, të cilët merren me procedurat Deportiv dhe 4 ndihmës daktiloskopikë.

2.2.1.2. Vakancat e konstatuara në organikë për pozicionin e përkthyesit, psikologut, mjekut dhe juristit

Një problematikë tjetër që konstatohet nga KShH gjatë procesit të intervistimit apo përzgjedhjes për të huajt, është mungesa e një përkthyesi dhe/ose psikologu (të dhënat e reflektuara në figurën 2. 15). Kjo problematikë është vërejtur edhe në monitorimet e realizuara më parë nga KShH dhe zgjidhjet e ofruara nuk janë të qëndrueshme dhe garantuese. Detyrimi për të patur përkthyes dhe/ose psikolog parashikuar në Seksionin III “Procedura e refuzimit të hyrjes në kufi”, pika 1 të Udhëzimit të Përzgjedhjes nr. 293, datë 04.06.2015. Kjo procedurë për shtetasit shqiptarë realizohet nga vetë PKK, SPK dhe KPK nëpërmjet përgjegjësve të turnit.

Orari i intervistës varionte rast pas rasti dhe sipas PKK. Kështu, në PKK Qafë-Morinë, kjo procedurë zgjaste mesatarisht 15 minuta ndërsa në PKK Tushemisht, kjo procedurë zgjaste 2-3 orë. Në rastet e kontakteve me të huajt, ky komunikim realizohej ose nga vetë punonjësit e policisë të cilët kishin njohuri të gjuhëve të ndryshme ose duke u vënë në dispozicion një përkthyes nga organizatat si CARITAS, UNHCR dhe në raste më të ralla nga Drejtoritë Rajonale të Kufirit dhe Migracionit (DRKM).

Figura 2. 13. Mungesa e personelit të shërbimit mjekësor, ligjor, përkthyes dhe psikologjik në PKK dhe SPK dhe KKM



KShH vëren me shqetësim se, në PKK-at në veri të vendit, përkatësisht Hani i Hotit, Muriqan dhe Qafë-Morinë përkthyesi dhe psikologu mungonte plotësisht. Po kështu, e njëjta problematikë u vërejt edhe në PKK në juglindje dhe në jug të vendit, Qafë Thanë dhe Tushemisht, si dhe në Stacionin e Policisë Kufitare Kapshticë. Në PKK-në Kapshticë, komunikimi me të huajt realizohej nga vetë punonjësit e policisë, ndërsa në PKK-në Qafë Thanë, përkthyesi dhe psikologu vihej në dispozicion nga Drejtoria Rajonale të Kufirit dhe Migracionit, Korçë.

KShH vërejti se në PKK Kakavijë, Stacionin e Kufirit Gosë, SPK Livadhja dhe Komisaratin e Kufirit dhe Migracionit Sarandë, përkthyesit e licensuar vihehin në dispozicion nga organizatat CARITAS dhe UNHCR. Përfaqësuesit e UNHCR-së ishin gjithmonë present gjatë fazës së intervistimit. Problematika u konstatuan në Komisaratin e Kufirit dhe Migracionit Sarandë, ku përkthyesit e licensuar të UNHCR-së vinin nga Gjirokastra, duke shkaktuar në këtë mënyrë një vonesë prej 1-2 orë, deri në ardhjen e tyre. Në Stacionin e Kufirit Gosë, në rastet e nevojës për

prezencën e psikologut, ai garantohej nga DVPMK Gjirokastrë. Gjithashtu, në këtë institucion u pohua se në rastin e të miturve, procedura e intervistimit realizohej në prezencën e prindit dhe të përkthyesit. Megjithatë, grupi i vëzhgimit të KShH-së konstatoi se në praktikën e 2 shtetasve të mitur nuk rezultonte prezenca e psikologut, ndërkohë që ata ishin shoqëruar nga nëna dhe babai gjatë intervistimit.

Edhe në KPK-në Rinas, nuk ishte i parashikuar pozicioni i psikologut, ndërsa përkthyesi vihet në dispozicion me autorizim nga DVPMK Tiranë, në rastet kur është e nevojshme.

Mangësi lidhur me përkthimin janë vërejtur edhe në procedurat e ndjekura me shtetasit shqiptarë të ndaluar nga palët fqinje. Kështu, në PKK Hani i Hotit, KShH, konstatoi rastin e një shtetasi shqiptar i cili kishte marrë një vendim në gjuhë të huaj por që rezultonte e padokumentuar prezenca e përkthyesit. Kjo praktikë mund të ketë krijuar probleme për ushtrimin e të drejtës së ankimit të këtij vendimi pranë institucioneve përgjegjëse të pales fqinje.

Një problematikë tjetër që konstatohet në PKK (Muriqan dhe Qafë-Morinë, Tushemisht, Qafë Thanë, Kapshticë, Kakavijë), SPK (Kapshticë, Gosë, Livadhja) dhe KKM (Sarandë, Rinas), është mungesa e stafit për ofrimin e shërbimit mjekësor dhe ligjor. Këto mungesa bien ndesh me detyrimin e parashikuar në Seksionin III “Procedura e refuzimit të hyrjes në kufi”, pika 1 të Udhëzimit të Përzgjedhjes nr. 293, datë 04.06.2015. Në të gjitha këto pika, stacione dhe komisarate, ndihma mjekësore ofrohej nga Spitalet Rajonale të secilit qytet. Kështu, për PKK Hani i Hotit, në rastet e problematikave shëndetësore që shfaqeshin te persona të ndryshëm, stafi i shoqëronte drejt Spitalit Rajonal Civil të Koplikut. Në PKK-në QafëThanë, mjeku vinte kryesisht nga DRVMK Korçë. Ndërsa në SPK Kapshticë, në rastet e problemeve shëndetësore nga emigrantët, stafi vetë i shoqëronte për në Spitalin Civil të Bilishtit. Në PKK Kakavijë dhe Stacionin e Kufirit Gosë migrantët merrnin trajtim mjekësor nga Spitali Rajonal i Gjirokastrës ndërsa në Komisaratin e Kufirit dhe Migracionit Sarandë, ndihma mjekësore ofrohej nga Spitali Rajonal i Sarandës.

Ashtu si në të kaluarën, KShH tërheq vëmendjen se prezenca e një mjeku në pikën e kalimit të kufirit, aty ku ndalohej i huaji dhe i nënshtrohet procesit të përzgjedhjes, mundëson identifikimin e shpejtë të rasteve me sëmundje ngjitëse, duke kufizuar përhapjen e sëmundjes tek të huaj të tjerë apo tek punonjësit e kufirit dhe migracionit. Policia e kufirit dhe migracionit, gjatë procesit të ndalimit, intervistimit dhe transferimit të të huajve në mekanizmat përkatës (të azilit, migrantëve të parregullt, viktimat e trafikimit të qenieve njerëzore) nuk përdorin masa, apo mjete mbrojtëse për të evituar marrjen e ndonjë sëmundje ngjitëse.

Një tjetër problemikë e konstatuar nga grupi i vëzhgimit të KShH-së është edhe mungesa e shërbimit ligjor për emigrantët që kërkojnë të ushtrojnë të drejtën e ankimit, por edhe për hartimin e akteve të ndryshme administrative të këtyre pikave. Kjo problematikë u vërejt në PKK QafëThanë, ku në organikë nuk ishte parashikuar pozicioni i Juristit.

2.2.1.3. Mungesa në staf e personelit të gjinisë femërore

Njësoj si në të kaluarën, KShH ka konstatuar gjatë monitorimit në institucionet e PKK-ve mungesë të personelit femëror të nevojshëm, për kontrollin e personave të ndaluar, të gjinisë

femëror si dhe në intervistimin e të huajve që kanë në kulturën apo traditën fetare, ndalimin e komunikimit midis femrave dhe meshkujve.

Vëzhguesit e KShH-së vërejtën se në SPK Kapshticë, nuk kishte personel të gjinisë femër, edhe pse në organikë parashikohen 41 funksione në total. E njëjta situatë paraqitet në SPK Livadhja, organika e personelit të cilës përbëhej nga 22 persona. Në rastet e kontrollit personal të personave të gjinisë femër, procedura kryhej nga ana e përgjegjësit të turnit, i cili i përkiste gjinisë mashkullore. Edhe në PKK Qafë Morinë, gjatë lokalizimit të personave në zonën e kufirit të gjelbër, procedura e kontrollit fizik realizohej nga punonjësit e policisë të gjinisë mashkullore. Ndërkohë, në PKK Muriqan, PKK Qafë Thanë dhe PKK Tushemisht kishte numër të kufizuar të punonjësve femra në raport me numrin total të punonjësve. Në PKK Muriqan, KShH vërejti se nga 37 punonjës në total, vetëm 4 prej tyre ishin femra. Edhe në organikën e PKK Tushemisht, nga 41 punonjës në total, gjendeshin vetëm 3 punonjëse të gjinisë femër. Ndërsa në organikën e PKK Qafë Thanë, nga 42 punonjës në total, kishte 5 punonjëse të gjinisë femër. Problematik ishte fakti se në Kufirin e Gjelbër nuk kishte punonjëse femra që të mundësonin mbulimin e vazhdueshëm të tij. Në momentin e kapjes së emigranteve të parregullta ose të miturve, gjatë kontrollit fizik të tyre dërgohej 1 punonjëse femër, për të asistuar në këtë procedurë. Megjithatë, KShH u informua se nuk kishte pasur asnjë rast të tillë në praktikë.

I vetmi institucion ku ka një prezencë të lartë të stafit femër, është KPK Rinas. Në organikën e këtij institucioni u bë me dije se ka më shumë punonjëse të gjinisë femër se sa meshkuj.

2.2.1.4. Domosdoshmëria e rritjes së kapaciteteve profesionale

Gjatë misionëve të monitorimit nga vëzhguesit e KShH, u referua si domosdoshmëri nga stafi i institucioneve, nevoja për organizimin dhe pjesëmarrjen në trajnime të ndryshme me qëllim rritjen e kapaciteteve të tyre, në disa drejtime që kanë të bëjnë jo vetëm me funksionet e tyre bazë, por edhe në fushën e të drejtave të njeriut. Kështu në PKK Hani i Hotit, Muriqan, Qafë Morinë dhe Kapshticë, punonjësit pohuan se kishin marrë pjesë në trajnime për të drejtat e njeriut, por pavarësisht faktit se kanë një eksperiencë 10 vjeçare, ata shprehën domosdoshmërinë dhe nevojën që të përfshihen në trajnime periodike edhe në fushën e të drejtave të njeriut. Ndryshe rezultoi në Komisariatën e Policisë Kufitare Rinas, ku u pohua se stafi i ishte nënshtruar trajnimeve të vazhdueshme nga ana e Akademisë së Sigurisë.

2.2.1.5. Parregullsi në zbatimin e rregulloreve dhe përpilimin e dokumentacionit

Sa i takon procedurën së intervistimit të personave nga autoritetet përgjegjëse të kufirit, vëzhguesit e KShH-së vërejtën mangësi në drejtim të dokumentimit të tij, si dhe praktika të ndryshme dhe jo të unifikuara, nga një PKK në tjetrën. Konkretisht, në PKK Muriqan, faza e intervistimit realizohej nga përgjegjësi i turnit, në momentin kur personi pasi kalonte në vijën e parë (pra tek kontrollori), rezultonte se kishte nevojë për verifikime të mëtejshme. Edhe në KPK Rinas, janë përgjegjësit e turnit të cilët realizojnë procedurën e intervistimit. Nga ana e kontrollorit të vijës së parë, ky proces dokumentohej në sistem, ndërkohë që intervistimi nga kontrollori i vijës së dytë nuk dokumentohej në ndonjë format zyrtar shkresor apo elektronik. Edhe në PKK Qafë Thanë, stafi intervistues nuk mbante një procesverbal intervistimi në raste të

tilla. Nga praktikat e verifikuara në këtë pikë, u konstatuan parregullsi në drejtim të mungesës së nënshkrimit të punonjësit të policisë që e ka plotësuar formularin.

Në SPK Livadhja, nga ana e stafit të KShH-së u konstatua plotësimi periodik i librit të dinamikës së shërbimit, ndërkohë që të dhënat mbi hyrje-daljet dokumentohen në Pikën e Kalimit në Rips. Ndërsa në PKK Muriqan nuk gjendej asnjë praktikë shkresore e dokumentacionit, pasi çdo praktikë ata e hidhnin në sistem dhe mund të gjendej vetëm në DVPMK Shkodër. Gjithashtu, në SPK Kapshticë, u vërejtën parregullsi në plotësimin periodik të librit, në formën e mungesës së pasqyrit të orës së shoqërimit dhe orës së daljes nga institucioni, çka krijon hapësira për abuzivitet në drejtim të afatit gjatë të cilit personi mund të mbahet në institucion.

2.2.2. Problematikat e konstatuara lidhur me mjetet logjistike dhe infrastrukturën e nevojshme


2.2.2.1. Mungesa e mjeteve dhe pajisjeve të nevojshme logjistike

Në drejtim të performancës së PKK-ve ndikojnë me kah dobësues, mangësitë lidhur me mjetet dhe pajisjet logjistike. Gjatë monitorimit, KShH konstatoi se për të kryer një kontroll të plotë të territorit që PKK-të mbulojnë, këto institucione kanë pasur mjete logjistike të limituara (figura 2.16). Kështu, PKK e Hanit të Hotit disponon kamera, dylbi termike dhe 2 mjete transporti. Edhe PKK Muriqan kishte në dispozicion kamera termike, por kishte mungesa në automjete, ndërkohë që automjetet ekzistuese ishin në gjendje të amortizuar. Punonjësit e PKK-së Muriqan referuan si problematikë edhe mungesën e uniformave, ndërkohë që uniformat aktuale nuk ishin rezistente ndaj kushteve atmosferike. Problematika e uniformave të vjetra u referua edhe në KPK Rinas. Nga vetë stafi u referua si faktor shkurajues, trajtimi jo i kënaqshëm financiar tyre.

PKK Qafë-Morinë kishte në dispozicion për kryerjen e mbikqyrjes tre automjete, një motor dhe dylbi, por u referua si problematike mungesa e kamerave termike. Ndërsa në kufirin me Maqedoninë e Veriut, PKK Qafë Thanë kishte në dispozicion për të kontrolluar kufirin e gjelbër, radarë, dylbi dhe 2 mjete transporti. Situata paraqitet më mirë në PKK Tushemisht ku për kufirin tokësor, disponohej 1 kamera termike funksionale, 2 automjete, por megjithatë patrullimi në shumicën e rasteve kryhej me këmbë. Kufiri liqenor monitorohej me ndihmën e 1 radari, i cili mbulon deri në ½ e kufirit blu, ndërkohë që pjesa ujore kontrollohej nga 1 mjet lundrues, i cili konsiderohet nga stafi si i mjaftueshëm.

Për realizimin e kontrollit, në SPK Kapshticë disponoheshin kamera termike (të llojit Smartdec) dhe 2 mjete 4x4, të cilat ishin në gjendje tepër të amortizuar. Kjo bënte që kontrolli tokësor të realizohej nëpërmjet patrullimit në këmbë. Edhe në PKK Kakavijë dhe SK Gosë, kishte mungesë të mjeteve që mundësonin transportin në terrenin e thyer malor për kontrollin e kufirit të gjelbër. Patrulla e kontrollit të kësaj pike, nuk dispononte as radarë dhe as kamera termike për mbikqyrjen e kufirit të gjelbër gjatë natës. Ndryshe ishte situata në SPK Livadhja, ku personeli i shërbimit të kontrollit dispononte një mjet 4 x 4, të cilin kishte pak kohë që u ishte vënë në dispozicion, si dhe një motor.

Figura 2. 14. Mjetet logjistike në funksion të kontrollit të kufirit nga PKK dhe SPK



2.2.2.3. Mungesa e infrastrukturës së nevojshme për akomodimin provizor dhe intervistim

KShH vëren se PKK Hani i Hotit, Muriqan dhe Komisarati i Kufirit dhe Migracionit Sarandë nuk kishin ambiente akomodimi në rastet e ndalimit të azilkërkuesve dhe migrantëve të parregullt. Konkretisht, në PKK Muriqan dhe Hani i Hotit, azilkërkuesit dhe migrantët e parregullt, pas përfundimit të procedurave të verifikimit nga ana e Drejtorisë së Migracionit, shoqëroheshin drejt Fshatit të Paqes, në të cilin kishte dhe një ambient ku jetonin njerëz të pastrehë. Në Komisaratin e Kufirit dhe Migracionit Sarandë, përfaqësuesi i këtij institucioni ngriti problematikën e mungesës së qendrës për akomodimin e të miturve të pashoqëruar.

Në disa pika të tjera si SPK Kapshticë, SK Gosë dhe SPK Livadhja, pavarësisht se ambientet akomoduese ekzistojnë, vërehen problematika në drejtim të kapacitetit të kufizuar akomodues, mirëmbajtjes dhe amortizimit të tyre. Kështu, në SPK Kapshticë, gjendeshin 2 dhoma, përkatësisht 1 dhomë e kategorizuar për femra dhe fëmijë, si dhe 1 dhomë për akomodimin e personave DEPORTIV. Në dhomën ku akomodohen femra dhe fëmijë, gjatë kqyrjes fizike të këtyre ambienteve nga vëzhguesit e KShH-së, u vërejt se mungonin krevatet, ndërkohë që në rastet e akomodimit të shtetasve përdorehin si shtroje dyshekët prej sfungjeri. Në Stacionin e Kufirit Gosë, KShH vërejt ekzistencën e 2 dhomave të izolimit, si dhe 2 dhoma të tjera të cilat

ishin të diferencuara për meshkuj dhe femra, por në rastin e akomodimit të pjesëtarëve të së njëjtës familjeje, personeli lejonte qëndrimin e tyre bashkë në të njëjtën dhomë. Kapaciteti akomodues i këtyre dhomave ishte përkatësisht 4 dhe 9 shtretër, por sipas përfaqësuesve të tij, ky stacion kishte në total 14 shtretër. Përkundrejt thënieve të stafit, nga verifikimi i vëzhguesve të KShH, u konstatua në dhomën e parë një dyshek i vendosur në tokë, ndërkohë që në dhomën e dytë nuk kishte asnjë dyshek. Personeli pohoi se në rast fluksi, këto materiale merreshin nga magazinat e stacionit. Edhe kapaciteti akomodues në Stacionin e Policisë Kufitare Livadhja kufizohej në 1 dhomë, në të cilën gjendeshin 6 krevate.

Ndryshe paraqitej situata në KPK-në Rinas, ku kishte ambiente akomodimi për personat e ndaluar. Megjithatë, në raste fluksi si psh gjatë stinës së verës, kapacitetet akomoduese kishin vështirësi në përballimin e fluksit. Konkretisht, KPK Rinas kishte 2 dhoma akomoduese si dhe një dhomë shoqërimi për persona ndaj të cilëve kishte filluar një procedim penal. Kjo dhomë ishte e ndarë nga ambienti i cili përdorej për akomodimin e femrave dhe të miturve. Ambientet akomoduese kishin tavolina dhe karrige, ndërkohë që shtetasit monitoroheshin me sistemin e kamerave.

KShH vëren se mjediset e intervistimit për shtetasit e riatdhesuar apo me probleme të kategorisë DEPORTIV/INAD, ishin ose të pamjaftueshme ose mungonin totalisht. Kështu në PKK Hani i Hotit, dhoma e intervistimit ishte me kubaturë tepër të vogël që e pamundësonte akomodimin e më shumë se 2 personave. Ndërsa në DVPMK Shkodër nuk u vërejt një ambient i veçantë për realizimin e intervistimit. Në PKK Tushemisht dhe Qafë Thanë, dhoma e intervistimit kishte vetëm 1 divan. Ndërsa në Komisariatit të Policisë Rinas ekzistonin këto ambiente por personeli nuk mundësoi për vëzhguesit e KShH-së verifikimin dhe kqyrjen e tyre.

2.2.2.4. Kushtet higjeno-sanitare

Vëzhguesit e KShH-së vërejtën se disa PKK, SPK dhe KPK kishin probleme me kushtet e këqija higjeno-sanitare të ambienteve të akomodimit. Kështu, në ambientet e SPK Kapshticë, u konstatua lagështirë dhe si rrjedhojë, suvaja e mureve kishte rënë. Kushtet higjenike ishin tepër të këqija ndërkohë që në tualet nuk kishte pajisje që mundësonin larjen si dush, mungonin peshqirat dhe detergjentët higjenizues. Në këtë PKK, kushtet higjenike të çadrave në momentin kur kishte fluks, ishin jashtë çdo standardi. Ky ambient nuk mirëmbahej as nga institucioni dhe as nga ana e organizatave si UNHCR apo CARITAS.

Në Stacionin e Kufirit Gosë, dhomat kishin kushte të mira, por higjena linte për të dëshiruar. KShH vërejt se në 2 dhomat e izolimit kishte një tualet të përbashkët, jo të diferencuar për femra dhe meshkuj. Në KPK Rinas, dhoma e dhoqërimit kishte lagështirë.

Vëzhguesit e KShH-së vërejtën në disa mjedise të intervistimit, kushtet higjeno-sanitare ishin të kufizuara. Mjedisi i intervistimit të PKK Tushemisht, kishte mungesë të ambientit të tualetit.

2.2.2.4. Mungesa e ushqimit, uji të pijshëm, ngrohjes, energjisë elektrike

KShH konstatoi në disa PKK, SPK dhe KPK probleme me ushqimin, ujin e pijshëm, ngrohjen, energjinë elektrike. Në terminalin e Komisariatit të Policisë Kufitare Rinas nuk mundësohej

trajtimi i shtetasve me ushqim. E njëjta situatë paraqitej në Komisaratin e Kufirit dhe Migracionit Sarandë, ku ushqimi sigurohet me ndihmën e UNHCR dhe CARITAS. Në SPK Kapshticë, stafi i institucionit bëri të ditur se ushqimi, në shumë raste, ishte siguruar dhe nga vetë punonjësit.

Një problem tjetër që u konstatua nga vëzhguesit e KShH-së, në një prej pikave kufitare, ishte mungesa e ujit të pijshëm. Në SPK Kapshticë u konstatua se ngrohja e ambienteve realizohej me dru. Gjithashtu, KShH vërejti se në dhomën e intervistimit të PKK Tushemisht, ngrohëset nuk punonin. I njëjti problem ishte edhe në SPK Gosë ku kaldaajat nuk ishin funksionale.

Vëzhguesit e KShH-së konstatuan se në SPK Kapshticë, dhoma në të cilën mbaheshin shtetasit e ndaluar, kishte ndriçim artificial të pamjaftueshëm, pasi funksiononte vetëm 1 llambë.

2.3. Monitorimi i respektimit të të drejtave të Azilkërkuesve në Qendrën Kombëtare Pritëse

2.3.1. Organika institucionale e personelit

Qendra Kombëtare Pritëse për Azilkërkuesit është e vendosur në zonën Babrru, Tiranë. Organika institucionale e punonjësve të kësaj qendre është e organizuar në dy sektorë, përkatësisht:

- a) Sektori i mbështetjes së azilkërkuesve, në të cilin janë 3 punonjës, konkretisht 1 psikolog, 1 punonjës social dhe 1 përkthyes i gjuhës angleze;
- b) Sektori i financave dhe shërbimeve mbështetëse, në të cilin janë 10 punonjës, konkretisht 1 shef finance, 1 specialist prokurimesh, 1 specialist i burimeve njerëzore, 1 punonjës protokolli, 3 guzhinierë, 1 magaziniere dhe 2 shoferë.

Në organikën e këtij institucioni nuk ishte i parashikuar funksioni i juristit dhe ky funksion mbulohej nga specialisti i prokurimeve. Për këshillimin ligjor për çështje të ndryshme rreth azilit, asistonte Drejtoria e Kufirit dhe Migracionit, si dhe e organizata RMSA. Stafi i institucionit referoi marrëdhënie shumë të mira bashkëpunimi dhe asistence nga organizata ndërkombëtare, si UNHCR.

Përveçse me kapacitete të kufizuara njerëzore, punonjësit në detyrë të kësaj qendre kishin edhe vështirësi të tjera në realizimin e detyrave të tyre. Kështu, psikologia e këtij institucioni nuk kishte një zyrë të veçantë, por e ushtronte funksionin në një ambient provizor. Raporti i vlerësimit psikologjik hartohej 1 herë në çdo 3-6 muaj për personat e akomoduar në mënyrë të qendrueshme në institucion, ndërsa për personat që largohen dhe kalojnë shumë pak kohë në institucion ky raport hartohet vetëm kur është objektivisht e mundur.

Qendra ka patur pengesa në gjetjen e kandidatëve të interesuar për mjek, si dhe përkthyes të gjuhës arabe, të cilët janë siguruar nga organizata RMSA. Gjithashtu, u konstatua vakancë në organikën e institucionit për pozicionin e infermierit. Aktualisht ky shërbim ofrohet në bashkëpunim me UNHCR dhe RMSA. Kjo e fundit ka vënë në funksion të institucionit 1 infermier full time dhe 2 kujdestarë nate. Gjithashtu, ushtron funksionin dhe 1 mjeke e cila vjen

në institucion me kohë të pjesshme, 2 herë në javë. Ndihma mjekësore ofrohej në çdo rast në mënyrë të menjëhershme dhe në raste të vështira dhe urgjente, apo nevojash për ndërhyrje kirurgjikale, bëhej transportimi i personave pranë Qendrës Spitalore Universitare Nënë Tereza, në Tiranë (QSUT). Shërbimet e stomatologjisë ndaj azilkërkuesve ofroheshin pranë klinikave private, të financuara kryesisht nga RMSA.

2.3.2. Njohja me rregulloren e Qendrës

Rregullorja e Qendrës Kombëtare Pritëse është hartuar në dy gjuhë, shqip dhe anglisht. Ky fakt i vetëm e pamundëson njohjen e saj nga individët të cilët nuk i njohin këto dy gjuhë. Gjithashtu, në aspektin formal, vëzhguesit e KShH-së vërejtën se komunikimi i rregullores tek azilkërkuesit nuk shoqërohej me nënshkrimin e tyre, pavarësisht seksionit të parashikuar në aktin e njohjes. Ky akt nuk ishte nënshkruar as nga ana e përkthyesit, i cili pretendonte se kishte qenë prezent gjatë momentit të akomodimit të shtetasve.

Stafi i Qendrës prapësoi se këto parregullsi janë krijuar si rrjedhojë e fluksit në mënyrë të papritur të shtetasve dhe mungesës së dijenisë paraprake mbi të dhënat e tyre.

2.3.3. Infrastruktura e kufizuar në raste fluksi

Kapaciteti akomodues i këtij institucioni është 180 persona. Gjatë monitorimit, stafi i KShH-së vërejtë një numër të ulët azilkërkuesish, rreth 50 të tillë, prej të cilëve 44 meshkuj, 3 femra dhe 3 të mitur të pashoqëruar. Ky fluks i ulët ishte si rrjedhojë e prezencës së FRONTEx në pikat e kalimit dhe përgjatë kufirit të gjelbër në territorin e vendit tonë.

Megjithatë, fluksi në qendër pësonte luhatje të vazhdueshme. 4-5 ditë më parë, nga monitorimi i KShH-së në këtë Qendër, fluksi i azilkërkuesve në të kishte qenë pothuajse sa dyfishi i numrit aktual, 106 azilkërkues. Stafi i Qendrës referoi se në rastet e flukseve të larta, situata paraqitet shqetësuese. Kjo veçanërisht në rastet e akomodimit për disa orë ose për një kohë të shkurtër të një kontigjenti të lartë azilkërkuesish.

Me akomodimin në Qendër, azilkërkuesi shoqërohet nga praktika e dokumentacionit e përpiluar nga Drejtoria e Kufirit dhe Migracionit.

Në rastet kur fluksi i azilkërkuesve është i lartë, në mjediset pritëse të Qendrës përdoren materiale shtesë (si dyshekë, jorganë etj). Stafi i Qendrës pretendoi se për aq sa është e mundur, akomodimi i familjeve bëhej bashkë, ndërsa minorenët e pashoqëruar vendosen në ambiente të ndarë nga personat e rritur. Megjithatë kjo ndarje gjatë momenteve të fluksit ishte e pamundur objektivisht.

Në qendër koha më e shkurtër e akomodimit të personave është 1 ditë, ndërkohë që nuk u vendosën në dispozicion statistika mbi kohëqëndrimin mesatar apo maksimal të azilkërkuesve.

2.3.4. Mangësitë në buxhet dhe mjetet logjistike

Në Qendrën Kombëtare Pritëse, për të akomoduarit vihen në dispozicion 3 vaktet e ditës, ndërkohë për të miturit ofrohet dhe vakti i “zemrës”. Megjithatë referohet sebuxheti i akorduar për institucionin, në pjesën më të madhe është i pamjaftueshëm në raport me nevojën e të akomoduarve për nevoja të ndryshme, si përsëmbull për veshmbathje. Kjo mungesë është përmbushur nga ndihma e ofruar nga CARITAS, si dhe në mënyrë individuale nga punonjësit e institucionit, që shpesh herë kanë sjellë rroba. Në Qendër nuk mungojnë aktivitetet festive të organizuara në bashkëpunim me organizatat, të cilat ofrojnë dhurata dhe katering për këta shtetas.

2.4. Zbatimi i ligjit, rregulloreve, urdhrave

2.4.1. Koha e qëndrimit në ambientet e shoqërimit

Ashtu si në të kaluarën, KShH ka vërejtur problematika në drejtim të mungesës së dokumentimit të kohës së qëndrimit të personave në ambientet e shoqërimit të institucioneve kufitare, ndërkohë që stafi i intervistuar pohon respektimin e afateve ligjore të shoqërimit.

Konkretisht, në ambientet e KPK-së Rinas gjendet vetëm dhoma e shoqërimit, në të cilën akomodohen personat deri në 10 orë, me qëllim identifikimin e tyre, bazuar në nenin 109 të Ligjit nr. 108/2014 “Për Policinë e Shtetit”.

Në PKK Hani i Hotit, emigrantët qëndronin maksimalisht 1 orë, ndërkohë në raste fluksesh i duhej që të prisnin në ambientet e jashtme të pikës, deri sa të përfundonte faza individuale e intervistimit. Edhe në SPK Kapshticë, stafi pohoi se shtetasit mbaheshin në ambientet e stacionit, 1-2 orë dhe pas verifikimeve në sistem lihen të lirë. Gjithashtu, në këtë pikë, koha e hyrjes së shtetasve në institucion dhe dalja prej tij nuk dokumentohej në asnjë akt, duke e bërë të pamundur verifikimin e orarit të kufizimit të lirisë së këtyre shtetasve dhe qëndrimin e tyre në ambientet e kësaj pike. Vëzhguesit e KShH-së konstatuan se ka patur raste që personat e ndaluar kanë qëndruar dhe më shumë se 24 orë në këtë institucion dhe nuk janë njohur me të drejtat e tyre dhe statusin procedural në të cilin janë mbajtur.

2.4.2. Parregullsitë në dokumentacion (formularë)

Në KPK Rinas, në formularin që plotësohej nga stafi për shtetasit e kthyer në kategorinë INAD, u vërejt mungesë e bazës ligjore, pra e mungesës së citimit të ligjit në të cilin bazohet ky kategorizim.

Vëzhguesit e KShH-së nuk vërejtën asnjë praktikë të refuzimit të hyrjes së shtetasve në Republikën e Shqipërisë. Ndërkohë që u konstatua një numër i lartë praktikash të ‘Refuzimit të daljes nga territori i RSH’. Autoriteti kufitar i Rinasit referonte si bazë ligjore të kësaj procedure nenin 13, pika 1 të Ligjit nr. 9861/2008¹⁶. Në përmbajtjen e formularit për refuzimin e daljes së

¹⁶Në këtë dispozitë parashikohet se “Kalimi i kufirit bëhet vetëm në pikat e kalimit kufitar, brenda orarit të caktuar, me dokumente të vlefshme udhëtimi apo me dokumente që autorizojnë kalimin e kufirit; me një vizë të vlefshme, nëse kërkohet, përveç kur disponohet një leje qëndrimi e vlefshme; kur justifikohet qëllimi dhe rrethanat e qëndrimit

këtyre shtetasve, u vërejt si parregullsi, mungesa e evidentimit të së drejtës së ankimit të tyre dhe procedura që duhet ndjekur në rast të ushtrimit të kësaj të drejte.

Në PKK Qafë Morinë, vëzhguesit e KShH-së vërejtën si parregullsi, mungesën e formularëve të “Refuzimit të hyrjes” dhe “Refuzimit të daljes”. Mos plotësimi i tyre nga ana e punonjësve ka rezultuar në një praktikë të gabuar, ku shtetasit nuk janë vënë në dijeni me anë të këtij dokumenti zyrtarisht, por atyre u është komunikuar gojarisht vendimi për refuzim.

2.4.3. Problematikat mbi zbatimin e Urdhërit nr. 805/2017 të Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit

Sipas urdhërit nr. 805 prot., datë 01.08.2017, lëshuar nga Drejtori i Përgjithshëm i Policisë së Shtetit, nuk lejohet kalimi i kufirit shtetëror nga shtetasit e përfshirë në kategorinë INAD (të kthyer pas datës 01.01.2016, pasi kanë thyer rregullat në zonën Schengen) si dhe nga shtetasit në kategorinë DEPORTIV (pas datës 01.01.2015). Zbatimi i këtij urdhëri ka sjellë kufizimin e lirisë së lëvizjes të një pjese të konsiderueshme shtetasish shqiptarë, të cilët janë kthyer në pikat e kalim kufirit të vendit tonë.

Kthimi i shtetasve shqiptar në zbatim të këtij urdhëri, ka shkaktuar shpesh situata të tensionuara mes qytetarëve dhe punonjësve të kufirit, veçanërisht nga reagimet e të kthyerve të cilët nuk kanë qënë të mirë informuar rreth parashikimeve të tij. Situata kritike është vërejtur në KPK Rinas, ku refuzimi i daljes së shtetasve u ka shkaktuar një dëm ekonomik të madh, pasi biletat e udhëtimit janë të kushtueshme. Situata paraqitet me më pak ngarkesë në PKK-të me Malin e Zi, Maqedoninë dhe Kosovën, ku dispozitat sanksionuese të urdhërit nuk mund të zbatohen për destinacione në shtete që nuk janë pjesë të zonës Schengen. Nga ana tjetër, në PKK Qafë Morinë, KShH konstatoi se punonjësit e kësaj pike e kanë të pamundur ta zbatojnë një urdhër të tillë, pasi ata nuk kanë një sistem apo regjistër daljeje. Ndërkohë në PKK Hani i Hotit, u vërejt një rritje e numrit të shtetasve të cilëve u ishte refuzuar dalja nga territori i RSH-së, në zbatim të këtij urdhëri.

të planifikuar dhe kur disponon mjete të mjaftueshme financiare; kur për personin nuk ka të dhëna në sistemin e të dhënave; kur nuk përbën kërcënim ndaj rendit dhe sigurisë publike dhe shëndetit publik apo ndaj marrëdhënieve ndërkombëtare me shtetet e tjera”.

REKOMANDIME

Rekomandimi 1: Ndërgjegjësimi i migrantëve dhe azilkërkuesve për të drejtat e tyre

KShH rekomandon të merren masa për afishimin e të drejtave të shtetasve azilkërkues dhe emigrantë në të gjitha PKK si dhe azhornimin e materialeve ndërgjegjëse ekzistuese. Kjo do të kontribuonte në njohjen më të mirë të shtetasve me këto të drejta që në momentin e hyrjes në institucionet e kalimit të kufirit, si dhe informimin e menjëhershëm të tyre në gjuhën që ata kuptojnë lidhur me statusin procedural në të cilin ato mbahen në kushtet e kufizimit të lirisë.

Rekomandimi 2: Përmirësimi i bashkëpunimit ndërkufitar midis palës shqiptare dhe asaj të huaj

Rekomandohet rritja dhe forcimi i bashkëpunimit më të frytshëm mes autoriteteve tona të kalim kufirit në pikat përkatëse dhe autoriteteve homologe në vendet kufitare fqinjë, në mënyrë që të shmanget ndërmarrja e praktikave diskriminuese, të cilat në rastet e mungesës së dokumentacionit justifikues mund të kthehen në cënim të së drejtës së lëvizjes së lirë. Në respektim të këtyre të drejtave për shtetasit shqiptarë të cilët kategorizohen në kategorinë DEPORTIV apo INAD, arsyetimi i vendimarrjes së dhënë duhet të jetë në gjuhën shqipe, ose në gjuhën angleze. Në disa PKK, në kufi me Greqinë, Maqedoninë dhe Malin e Zi, vëzhguesit e KShH-së vërejtën se shtetasit shqiptarë që ju ndalohej hyrja nga këto shtete apo ktheheshin prej tyre, nuk kishin dokumentacionin e duhur justifikues për arsyet e ndalimit/kthimit dhe ushtrimin e të drejtës së ankimit (si psh rastet me apellas që pala greke kishte dhënë ndaj shtetasve shqiptarë).

Rekomandimi 3: Standartizimi i procedurave dhe dixhitalizimi i dokumentacionit në lidhje me praktikën e ndalim-kalimit

KShH rekomandon unifikimin e praktikës për përdorimin e formularëve të “Refuzimit të hyrjes/daljes nga territori i Republikës së Shqipërisë”, për shtetasit shqiptarë, me qëllim shmangien e parregullsive dhe të praktikave të pa unifikuara për të njëjtën procedurë. **Në standartizimin e kësaj procedure KShH sugjeron gjithashtu të parashikohet qartësisht në këtë akt, baza ligjore e kësaj vendimarrje dhe e drejta e ankimit në bazë të Kodit të Procedurave Administrative apo ligjit të posaçëm.**

Përsa i përket procedurave të intervistimit, përzgjedhjes apo praktikave të vendimarrjes, për të gjitha PKK, rekomandohet të dokumentohen në formularë të posaçëm dhe një kopje të dosjeve në format hard copy, rastet e shtetasve Deportiv/Inad/Refuzim Hyrje dhe Refuzim Dalje. Gjithashtu, për kategorinë e shtetasve INAD dhe Deportiv, rekomandohet standartizimi i regjistrave të mbajtura me qëllim shmangien e praktikave të ndryshme.

Për PKK me shtetin grek, rekomandohet të standardizohet terminologjia e përdorur nga ana e punonjësve të policisë kufitare dhe praktikën e ndjekura për referimin e rasteve të shtetasve ndaj të cilëve është vendosur masa represive “Apellas”.

Rekomandimi 4: Shtimi i organikës, plotësimi i vakancave, rritja e kapaciteteve të stafit, përmirësimi i infrastrukturës

KShH, duke marrë në konsideratë nevojat dhe mangësitë e konstatuara gjatë monitorimeve në terren të PKK, vëçanërisht gjatë periudhave të flukseve **rekomandon të merren masat e nevojshme për shtimin e organikës si dhe plotësimin e vakancave të konstatuara**, sipas gjetjeve të parashtruara në këtë raport (për pozicione të kontrollorit, psikologut, personelit shëndetësor, përkthyesit si dhe shtimin e personelit të gjinisë femër).

Gjithashtu KShH rekomandon organizimin e trajnimeve multi-tematike të stafit të PKK, lidhur me aspekte të ndryshme të të drejtave të njeriut me qëllim rritjen e profesionalizmit të stafit në aspektin e njohjes së procedurave, komunikimit, njohjen e ligjeve dhe konventave ndërkombëtare.

Gjithashtu për një pjesë të PKK-ve (Tushemisht, Kakavijë, Stacioni i Kufirit Gosë, Stacioni i Policisë Kufitare Livadhja, Komisariati i Kufirit dhe Migracionit Sarandë), është e nevojshme të investohet për përmirësimin e kushteve infrastrukturore, me qëllim ofrimin e akomodimit në kushtet e një jetese normale për migrantët e azilkërkuesit dhe marrjen e masave të menjëhershme për përmirësimin e kushteve higjeno-sanitare.

Rekomandimi 5: Përmirësimi i kushteve dhe shërbimeve për azilkërkuesit në mjediset pritëse brenda territorit shqiptar

KShH rekomandon se në Qendrën Kombëtare Pritëse Babrru, duhet të merren masa për ofrimin e këshillimeve/trajtimeve psikologjike individuale në një kohë të shkurtër ndaj shtetasve të akomoduar. KShH sugjeron krijimin e kushteve për akomodimin e psikologut/punonjësit social në zyrë individuale, duke shmangur këshillimin/trajtimin psikologjik në ambiente provizore.

KShH sugjeron rritjen e buxhetit që do të alokohet në vijimësi Qendrës Pritëse të Azilkërkuesve në Babrru, për të rritur autonominë e saj dhe për të përmirësuar shërbimet bazike ndaj azilkërkuesve, me teshat e fjetjes, veshmbathje, sistemin ngrohës, ushqim, etj. Në këtë qendër u konstatua se buxheti i alokuar është në proporcionalitet të zhdrejtë me nevojën e shtetasve të akomoduar. Gjithashtu sugjerorjmë shtimin e organikës së kësaj qendre me një staf jurist, si dhe me staf të përkoshëm, në rastet e fluksit.

LITERATURA

- ❖ KShH, 2018, *Raport studimor “Mbi të drejtat dhe liritë e emigrantëve, azilkërkuesve dhe refugjatëve në Shqipëri për periudhën 2012-2017”*.
- ❖ Strategjia kombëtare për qeverisjen e migracionit dhe plani i veprimit 2019 – 2022

Site Interneti

- ❖ <https://neës.un.org/fr/story/2018/12/1031391>
- ❖ https://ec.europa.eu/neighbourhoodenlargement/sites/near/files/pdf/key_documents/2014/20141008-albania-progress-report_en.pdf
- ❖ <https://ec.europa.eu/eurostat/data/database>
- ❖ <http://ëëë.instat.gov.al/media/6181/foreigners-and-asylum-seekers-2018.pdf>
- ❖ https://mb.gov.al/ëp-content/uploads/2018/02/Profili_i_Migracionit_2016_Eng.pdf
- ❖ https://ec.europa.eu/home-affairs/sites/homeaffairs/files/ëhat-ëe-do/policies/european-agenda-migration/20181219_sëd-2018-496-report_en.pdf
- ❖ <https://albania.iom.int/sites/default/files/publication/62.%20Readmission%20Assessment%20Report.pdf>
- ❖ <http://ëëë.instat.gov.al/en/themes/demography-and-social-indicators/migration-and-migrant-integration/>
- ❖ https://ec.europa.eu/eurostat/statisticsexplained/index.php?title=Migration_and_migrant_population_statistics
- ❖ <https://ahc.org.al/>

ANEKS

Aneks 1. Statistikat e migrantëve për periudhën Shtator 2018-Qershor 2019

Tabela a. 1. Numri i Udhëtareve dhe i Automjeteve që kanë Hyre/Dale në Piken Kufitare Qafe Morine për periudhën Janar – Shtator 2018

Hyrje/Dalje	SHUMA
Hyrjeshtetasshqiptarë	115627
Daljeshtetasshqiptarë	109492
Hyrjeshtetas të huaj	59436
Daljeshtetas të huaj	46889

Tabela a. 2. Hyre/Dale në Piken Kufitare Qafe Morine për periudhën Janar – Shtator 2018

Arsyeja e ndalimit	Persona
Shtetasshqiptarë të kapur në kerkim kombëtar	4
Persona të kapur në kerkim për llogari të Kosovës	13
Persona të kapur në kerkim Nderkombëtar	1
<i>Masa administrative, gjëra të vëna</i>	1
Shtetas të kontrolluar si të dyshuar	94
Automjete të bllokuara	4
Shtetas të ndjekur penalisht	0
Shtetas të prapsuar, pasi ishin të deportuar nga vendet e shengenit	9
Pasaporta të bllokura zviceriane	1
Karte Identiteti Austriake	1
Shtetas të prapsuar në hyrje	3
<u>Veprat Penale</u>	3

Aneks2. Urdhëzimet e lëshuarangainstitucionetpërgjegjëse tëmigracionit

Figura a. 1. Udhëzim Nr.645/2015 për rregullatdheprocedurat për marrjen e informacionitdheverifikimin e të dhënave e të deklarimevengavendi i origjinës për azilkërkuesitdherefugjatët.




Figura a. 2. Udhëzim Nr.293, datë 04.06.2015 mbiprocedurat e trajtimit të shtetasve të huaj me qëndrim të parregullt në territorin e RSH


REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E PUNËVE TË BRENDSHME
MINISTRI

Nr. 3663/ Pres.
Tiranë, më 04.06 2015

UDHËZIM

Nr. 293, datë 04.06 2015

MHI

PROCEDURAT E TRAJTIMIT TË SHITETASVE TË HUAJ ME QËNDRIM TË PARREGULLT NË TERRITORIN E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË.

Në mbështetje të nenit 102, pika 4 të Kushtetutës, të nenit 21 të Ligjit nr. 108/2014 "Për Policinë e Shtetit", në zbatim të nenëve 10, 11, 106, 109, 111, 115, 118 dhe 128 të Ligjit nr. 108/2013 "Për të Huajt", me qëllim harmonizimin e procedurave për trajtimin e shtetasve të huaj të parregullt në Republikën e Shqipërisë,

UDHËZOJ:

I. PROCEDURAT E PËRZGJEDHJES SË SHITETASIT TË HUAJ I CILI NUK PLOTËSON, OSE QË NUK I PLOTËSON MË KUSHTET PËR HYRJE DHE QËNDRIM NË TERRITORIN E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË.

1. Autoriteti Rajonal Vendor për Kufirin dhe Migracionin është autoriteti shtetëror përgjegjës për kryerjen e procedurës së përzgjedhjes së të huajit i cili nuk plotëson, më kushtet për hyrje dhe qëndrim në territorin e Republikës së Shqipërisë.
2. Procesi i përzgjedhjes kryhet në kufi ose brenda territorit dhe ka për qëllim përcaktimin e kategorisë së të huajit, duke e klasifikuar atë si:
 - a) subjekt i refuzimit të hyrjes;
 - b) azikërkues;
 - c) viktimë e mundshme trafikimi;
 - d) imigrant i parregullt;
 - e) i mitur i pasqoqësuar.

1

Figura a. 3. Udhëzim Nr. 805 datë 01.05.2017 për forcimin e kontrollit të shtetasvëshqiptarëqë kalojnëkufirinshetëror


REPUBLIKA E SHQIPËRISE
MINISTRIA E PUNËVE TË BRENDSHME
Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit
Adresa: Dëshmorët "Bajram Curri", Tirinë, Shqipëri

Nr. 5732 / 2017 Dt. 01.05.2017

URDHËR
Nr. 805 datë 01.05.2017

**PËR
FORCIMIN E KONTROLLIT TË SHITESAVE SHQIPTAR QË KALOJNË KUFIRIN
SHETËROR**

bazuar në ligjin nr. 71/2016 "Për kontrollin kufitar", nën 6 pika dhe pika 6 "Kompetencat e Policisë Kufitare dhe të Migracionit në kufi", nën 13 "Verifikimet kufitare" dhe nën 14 "Verifikimi kufitar i personave", nën 15 "Verifikimi i shtetësisë dhe mjeteve të transportit", në Marrëveshjen ndërmjet Komisionit të Evropës dhe republikës së Shqipërisë "Për ripartimin e Personave që vendësojnë në shtetësi", në Udhëzimin e përshkruar nr. 315, datë 27.09.2016 "Për përpunimin e të dhënave personale nga rojet kufitare" të Ministrisë të Punëve të Brendshme dhe Komisionit për të Drejtën e Individit dhe Migracionit dhe Mbrojtjes së Dhomave Personale, si dhe në udhëzimin e MPP nr. 379, datë 20.10.2016 "Për informacionin që u jepet personave të cilët janë subjekt i verifikimit të shtetësisë në pikat e kalimit kufitar", duke vlerësuar se funksionimi i kontrollit të shtetasve shqiptar, në vendet e BE-së është bërë një shqetësim i madh, që mund të rrezikojë lirinë e lirisë të shtetasve shqiptar, me qëllim forcimin e kontrollit të shtetasve shqiptar në dalje nga kufiri shetëror,

URDHËROJ:

- Në dalje të kufirit shetëror të forcohet kontrolli i shtetasve shqiptar, që nuk plotësojnë kushtet e ndalimit për hyrjen dhe qëndrimin në vendet e Schengen/ BE-së, duke kryer verifikime dhe intervistime të detajuara, si:
 - Adresën e saktë të qëndrimit në vendin e destinacionit (të përmasave kontaktet e pritësit);
 - Presa e pritësit në vendin e destinacionit (të përmasave kontaktet e pritësit);
 - Bileta/rezervimi për kthimin;
 - Mjete financiare për mbulimin e shpenzimeve për kohën e qëndrimit;
- Në funksion të kontrollit të verifikimit kufitar ndaj të gjithë shtetasve shqiptar që kanë shënim, njoftime dhe informacionet e autoriteteve ligjvënuese, të shfaqura automatikisht ose me kërkim në sistemet elektronike, si dhe ato që mbërrijnë

Adresa: Dëshmorët "Bajram Curri", Tirinë - Shqipëri, www.mpp.gov.al e-mail: shqiperia@bajramcurri.gov.al - Paga 1

Figura a. 4. Model Urdhër largimi

ANEXE 1


REPUBLIKA E SHQIPËRIE
MINISTRIA E PUNËVE TË BRENDSHME
 Drejtoria Përgjithshme e Policisë së Shtetit
 Departamenti i Kufirit dhe Migracionit
 Drejtoria Vendore për Kufirin dhe Migracionin

Urdhër Largimi
 Removal Order

Nr. _____ Data _____
 Nr. _____ Data _____

Ky urdhër iqë tërheqet i Republikës së Shqipërisë të shpallur
 On the request from the territory of the Republic of Albania of date: _____

URDHËRU
I ORDER

1. Largimi nga territori i Republikës së Shqipërisë të shpallur
 The subject from the territory of the Republic of Albania of date: _____

Emri: Family name: Emri i Parë i: Patronymic: Data e lindjes: Date of birth: Shprehja: Nationality:	Emri: First name: Emri i Mënyrës: Maternal name: Vendi i lindjes: Place of birth: Dokumenti që shpreh për: Travel document no:
--	---

Në mënyrë të ligjshme: Ligji Nr. 133/13 "Për lirin e lirisë", Neni 106, për arsyet e vijimit
 issued on Law no. 133/13, Article 106, On Liberty for the following reasons:

☐ (a) nënshkrimi i kësaj lirisë të shpallur në Shqipëri, sipas përcaktimit të kësaj ligje
 issued on 133/13 conditions for entry and stay in the Republic of Albania, according to the provisions of the law

☐ (b) nënshkrimi i kësaj lirisë të shpallur në Shqipëri, sipas përcaktimit të kësaj ligje
 issued on 133/13 conditions for entry and stay in the Republic of Albania, according to the provisions of the law

☐ (c) nënshkrimi i kësaj lirisë të shpallur në Shqipëri, sipas përcaktimit të kësaj ligje
 issued on 133/13 conditions for entry and stay in the Republic of Albania, according to the provisions of the law

2. Ky urdhër largimi nga territori i kësaj shteti të shpallur
 This order from the territory of this state is issued after being issued

3. Ky urdhër largimi nga territori i kësaj shteti të shpallur
 This order from the territory of this state is issued after being issued

4. Ky urdhër largimi nga territori i kësaj shteti të shpallur
 This order from the territory of this state is issued after being issued

5. Ky urdhër largimi nga territori i kësaj shteti të shpallur
 This order from the territory of this state is issued after being issued

6. Ky urdhër largimi nga territori i kësaj shteti të shpallur
 This order from the territory of this state is issued after being issued

Kryetari:
 The Chief of Police

DREJTORI
 Director
 Kryekomisar Idajet HOXHA

Niveli i lirisë të shpallur: _____ Data _____
 The level of the issued liberty: _____ Date: _____

Aneks 3. Foto dhedokumenta që pasqyrojnë situatën e institucioneve të kufirit

Figura a. 5. Qendrat e akomodimit për emigrantët në Stacionin e Policisë Kufitare Kapshticë



LISTA E FIGURAVE DHE E TABELAVE

Kapitulli 1

Figura 1. 1. Institucionet kufitare dhe të migracionit të monitoruara nga vëzhguesit e KShH13

Kapitulli 2

Figura 2. 1. Numri i shtetasve të ndaluar në hyrje-dalje, nga institucionet kufitare, për periudhën e studimit15

Figura 2. 2. Numri i shtetasve të kategorizuar shqiptarë dhe të huaj, të ndaluar në hyrje-dalje të kufirit dhe doganave prej institucionet kufitare, për vitin 201815

Figura 2. 3. Numri i shtetasve të kategorizuar në shqiptarë dhe të huaj, të ndaluar në hyrje-dalje të kufirit dhe doganave prej institucionet kufitare, për vitin 2018.....16

Figura 2. 4. Shkaqet e ndalimit në hyrje-dalje të kufirit dhe doganave prej institucionet kufitare për shtetasit shqiptarë, për vitin 201817

Figura 2. 5. Shkaqet e ndalimit në hyrje-dalje të kufirit dhe doganave prej institucionet kufitare për shtetasit e huaj, për vitin 201818

Figura 2. 6. Numri i masave administrative dhe penale për shqiptarët dhe të huajt, në RSH, të dhëna nga PKK dhe KKM, për vitin 201820

Figura 2. 7. Numri i masave administrative për shqiptarët dhe të huajt, në PKK, për vitin 2018.21

Figura 2. 8. Numri i masave penale sipas neneve të Kodit Penal për shqiptarët, në PKK, viti 201823

Figura 2. 9. Numri i masave penale për shqiptarët dhe të huajt, në PKK, për vitin 2018.....**Error!**

Bookmark not defined.

Figura 2. 10. Numri i të regjistruarëve azilkërkues, në Qendra Kombëtare Pritëse Babrru për periudhën 2017-201924

Figura 2. 11. Shpërndarja e numri të azilkërkuesve në Qendra Kombëtare Pritëse Babrru sipas strukturës moshore dhe gjinore, për periudhën Janar – Maj 2019.....24

Figura 2. 12. Shpërndarja e numri të azilkërkuesve sipas shtetësisë për periudhën Janar – Maj 2019.....25

Figura 2. 13. Shtrirja gjeografike e kontrollit të kufirit nga PKK dhe SPK të monitoruara nga KShH.....26

Figura 2. 14. Burimet njerëzore në funksion të kontrollit të kufirit nga PKK dhe SPK të kostatuara nga KShH.....27

Figura 2. 15. Mungesa e personelit të shërbimit mjeksor, ligjor, përkthyes dhe psikologjik në PKK dhe SPK dhe KKM.....29

Figura 2. 16. Mjetet logjistike në funksion të kontrollit të kufirit nga PKK dhe SPK të kostatuara nga KShH33

Aneks

Figura a. 1. Udhëzim Nr.645/2015 për rregullat dhe procedurat për marrjen e informacionit dhe verifikimin e të dhënave e të deklarimeve nga vendi i origjinës për azilkërkuesit dhe refugjatët.43

Figura a. 2. Udhëzim Nr.293, datë 04.06.2015 mbi procedurat e trajtimit të shtetasve të huaj me qëndrim të parregullt në territorin e RSH.....44

Figura a. 3. Udhëzim Nr. 805 datë 01.05.2017 për forcimin e kontrollit të shtetasve shqiptarë që kalojnë kufirin shtetëror45

Figura a. 4. Model Urdhër largimi46

Figura a. 5. Qendrat e akomodimit për emigrantët në Stacionin e Policisë Kufitare Kapshticë ...47

Tabela a. 1. Numri i Udhetareve dhe i Automjeteve që kanë Hyre/Dale në Piken Kufitare Qafe Morine për periudhën Janar – Shtator 201842

Tabela a. 2. Hyre/Dale në Piken Kufitare Qafe Morine për periudhën Janar – Shtator 2018.....42